

LIGJ
Nr.8438, datë 28.12.1998

PER TATIMIN MBI TË ARDHURAT*

(Ndryshuar me ligjet: nr. 8711, datë 15.12.2000, nr. 8841, datë 11.12.2001, nr. 8979, datë 12.12.2002, nr. 9161, datë 18.12.2003, nr. 9326, datë 6.12.2004, nr. 9431, datë 13.10.2005, nr. 9458, datë 21.12.2005, nr.9483, datë 16.2.2006,nr. 9632, datë 30.10.2006, nr. 9716, datë 16.4.2007, nr. 9735, datë 17.5.2007, nr.9766, datë 9.7.2007, nr. 9804, datë 13.9.2007, nr. 9844, datë 17.12.2007, nr. 9943, datë 26.6.2008, nr. 10072, datë 9.2.2009, nr. 10228, datë 4.2.2010, nr. 10343, datë 28.10.2010, nr. 10364, datë 16.12.2010, nr.20, datë 1.3.2012, nr. 71, datë 28.6.2012, nr. 122, datë 20.12.2012, nr. 107, datë 28.3.2013, nr. 124, datë 25.4.2013, nr. 177, datë 28.12.2013, nr. 32, datë 3.4.2014, nr. 42, datë 24.4.2014, nr. 83, datë 17.7.2014, nr. 156, datë 27.11.2014, nr. 129/2016, datë 15.12.2016; nr.105, datë 30.11.2017, nr. 39/2018, datë 9.7.2018, ndryshuar me ligjin nr. 94/2018, datë 3.12.2018)
(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 81, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKS SE SHQIPERISE VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objektivi

** Ligji nr.8438, datë 28.12.1998 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 32; - Ligji nr. 8711, datë 15.12.2000 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 47, datë 4 janar 2001; - Ligji nr. 8841, datë 11.12.2001 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 58, datë 26 dhjetor 2001; - Ligji nr. 8979, datë 12.12.2002 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 82; - Ligji nr. 9161, datë 18.12.2003 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 105, datë 31 dhjetor 2003; - Ligji nr. 9326, datë 6.12.2004 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 103, datë 29 dhjetor 2004; - Ligji nr. 9431, datë 13.10.2005 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 83, datë 7 nëntor 2005; -Ligji nr. 9458, datë 21.12.2005 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 105, datë 17 janar 2006; - Ligji nr. 9483, datë 16.2.2006 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 20, datë 17 mars 2006; - Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 123, datë 27 nëntor 2006; - Ligji nr. 9716, datë 16.4.2007 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 54, datë 12 maj 2007; - Ligji nr. 9735, datë 17.5.2007 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 63, datë 4 qershor 2007; - Ligji nr. 9766, datë 9.7.2007 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 90, datë 21 korrik 2007;- Ligji nr. 9804, datë 13.9.2007 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 125, datë 27 shtator 2007; - Ligji nr. 9844, datë 17.12.2007 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 180, datë 4 janar 2008 dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2008; -Ligji nr. 9943, datë 26.6.2008 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 114, datë 22 korrik 2008; Ligji nr. 10072, datë 9.2.2009 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 20, datë 4 mars 2009; - Ligji nr. 10228, datë 4.2.2010 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 13, datë 25 shkurt 2010; - Ligji nr. 10343, datë 28.10.2010 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 159, datë 3 dhjetor 2010; - Ligji nr. 10364, datë 16.12.2010 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 179, datë 9 janar 2011; - Ligji nr. 20, datë 1.3.2012 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 26, datë 27 mars 2012; - Ligji nr. 71, datë 28.6.2012 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 89, datë 31 korrik 2012 dhe hyn në fuqi më 1 janar 2013; - Ligji nr. 122, datë 20.12.2012 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 177, datë 9 janar 2013; - Ligji nr. 107, datë 28.3.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 53, datë 15 prill 2013; - Ligji nr. 124, datë 25.4.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 76, datë 10 maj 2013; - Ligji nr. 177, datë 28.12.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 203, datë 30 dhjetor 2013 dhe hyn në fuqi më 1 janar 2014; - Ligji nr. 32, datë 3.4.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 57, datë 24 prill 2014; - Ligji nr. 42, datë 24.4.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 70, datë 20 maj 2014; - Ligji nr. 83, datë 17.7.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 126, datë 11 gusht 2014; Ligji nr. 156, datë 27.11.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 195, datë 24 dhjetor 2014 dhe hyn në fuqi më 1 janar 2015; - Ligji nr. 129/2016, datë 15.12.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 259, datë 6 janar 2017; - Ligji nr. 105/2016, datë 30.11.2015 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 222, datë 19 dhjetor 2017 dhe hyn në fuqi më 1 janar 2018. - Ligji nr. 39/2018, datë 9.7.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 134, datë 18 shtator 2018 dhe hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, me përjashtim të nenit 3, i cili hyn në fuqi më 1 janar 2019; - ligji nr. 94/2018, datë 3.12.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 183, datë 21 dhjetor 2018 dhe hyn ne fuqi më 1 janar 2019.*

Me këtë ligj rregullohen marrëdhëniet që lindin në fushën e tatimit mbi të ardhurat personale, tatimit mbi fitimin si dhe të tatimit të mbajtur në burim të të ardhurave.

Neni 2

Përkufizime

(Ndryshuar me ligjin nr. 8841, datë 11.12.2001; shtuar paragrafi i tretë me ligjin nr. 8979, datë 12.12.2002; shfuqizuar pika 3 me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006; ndryshuar fjalët në nënndarjet "iii" dhe "iv" të gurmës "b" të pikës 1 me ligjin nr. 10072, datë 9.2.2009; Shtuar pika 4 me ligjin nr. 42, datë 24.4.2014)

1. Për qëllim të këtij ligji:

a) emërtimi "tatimpagues" nënkupton çdo person që i nënshtrohet detyrimit të tatimit sipas këtij ligji;

b) emërtimi "person" nënkupton:

i) një "individ" (person fizik jotregtar sipas Kodit Civil);

ii) një "person fizik" (person fizik tregtar);

iii) një "person juridik" (shoqëri tregtare, e themeluar sipas ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", personat e tjerë juridikë të themeluar sipas Kodit Civil, të cilët ushtrojnë veprimtari fitimprurëse në Republikën e Shqipërisë, si dhe personat e tjerë juridikë të themeluar ose të njohur si të tillë me ligje të veçanta);

iv) një "ortakëri", si bashkim personash, fizikë dhe juridikë, për të kryer një veprimtari të përkohshme, të përbashkët me qëllim fitimi, që nuk krijohet si person juridik më vete në format e parashikuara nga ligji "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", nga Kodi Civil ose nga ligje të veçanta.

c) dy persona konsiderohen "persona të lidhur", nëse njëri prej tyre vepron ose mund të veprojë në përputhje me drejtimit, kërkesat, sugjerimet apo dëshirat e personit tjetër ose që të dy veprojnë ose mund të veprojnë në përputhje me drejtimit, kërkesat, sugjerimet apo dëshirat e një personi të tretë, pavarësisht nëse këto drejtimit, kërkesa, sugjerime apo dëshira, janë komunikuar (deklaruar). Në veçanti do të konsiderohen si "persona të lidhur" personat e mëposhtëm:

i) bashkëshortët, prindërit e tyre apo fëmijët e tyre;

ii) një shoqëri tregtare apo çdo person, që zotëron drejtpërdrejt ose tërthorazi 50 përqind ose më shumë, në vlerë apo në numër, të aksioneve apo të fuqisë votuese të një shoqërie tjetër.

iii) dy ose më shumë shoqëri, nëse një person i tretë zotëron drejtpërdrejt ose tërthorazi 50 përqind ose më shumë, në vlerë apo në numër, të aksioneve ose të fuqisë votuese në secilën shoqëri.

2. a) Emërtimi "Seli e përhershme", nënkupton një vend të caktuar biznesi, nëpërmjet të cilit ushtrohet tërësisht apo pjesërisht biznesi i një personi.

b) Do të konsiderohen seli të përhershme: një zyrë administrative, një degë, një fabrikë, një punishte, një minierë apo çdo vend tjetër për shfrytëzimin e burimeve natyrore, si dhe një shesh ndërtimi, rikonstruksioni, instalimi apo montimi.

c) Një person nuk do të konsiderohet se ka një seli të përhershme nëse ai:

i) përdor mjediset vetëm për qëllim magazinimi apo ekspozimi të mallrave që i përkasin atij personi;

ii) mban një gjendje mallrash që i përkasin atij personi vetëm me qëllim magazinimi apo ekspozimi;

iii) mban një gjendje mallrash që i përkasin atij personi vetëm për qëllim përpunimi nga një person tjetër;

iv) mban një vend të caktuar biznesi vetëm për qëllim blerjeje mallrash apo për mbledhje të dhënash për biznesin e atij personi;

v) mban një vend të caktuar biznesi vetëm për qëllim ushtrimin e çdo veprimtarie përgatitore apo ndihmëse për biznesin e atij personi.

ç) Pavarësisht nga dispozitat e shkronjave "a" dhe "b" të sipërpërmendura, kur një agjent i ndryshëm nga një agjent i pavarur, ndaj të cilit zbatohet shkronja "d" e përmendur më poshtë, vepron në emër të një personi, ka dhe zakonisht ushtron një autoritet për të përfunduar kontrata

në emër të atij personi. Ai person do të trajtohet njëloj sikur të kishte një seli të përhershme në vendin ku ushtrohen këto veprimtari, për çdo veprimtari që kryen agjenti për atë person, përveç rasteve kur veprimtaritë e agjentit kufizohen në shkronjën "c" të përmendur më sipër, të cilat edhe kur ushtrohen nëpërmjet një vendi të caktuar biznesi, nuk do ta bënin atë vend të caktuar biznesi një seli të përhershme.

d) Një person nuk do të konsiderohet se ka një seli të përhershme kur ai ushtron biznesin e tij nëpërmjet një ndërmjetësi, agjenti komisioner të përgjithshëm, apo çdo agjenti tjetër me një status të pavarur, me kusht që këta agjentë të veprojnë në kuadër të zakonshëm të biznesit të tyre.

dh) Fakti që një shoqëri kontrollon ose kontrollohet prej një shoqërie tjetër, nuk përbën në vetvete arsye për ta quajtur secilën shoqëri seli të përhershme të tjetrës.

3. Shfuqizuar.

4. Për qëllime të neneve 36-36/7 të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) Dy persona konsiderohen të jenë palë të lidhura, kur:

i) një person merr pjesë direkt apo indirekt në menaxhimin, kontrollin apo kapitalin e personit tjetër; ose

ii) i njëjti/të njëjtët person/persona marrin pjesë direkt apo indirekt në menaxhimin, kontrollin apo kapitalin e të dy personave.

b) Një person merr pjesë direkt ose indirekt në menaxhimin, kontrollin apo kapitalin e një personi tjetër, kur:

i) ai person zotëron, direkt ose indirekt, 50 për qind ose më shumë të kapitalit aksionar të personit tjetër; ose

ii) efektivisht kontrollon vendimet e biznesit të këtij personi tjetër.

c) "Palë të pavarura" janë palët që nuk janë palë të lidhura.

ç) "Transaksion i kontrolluar" është:

i) çdo transaksion midis palëve të lidhura, kur:

- njëra nga palët në transaksion është rezidente dhe tjetra jorezidente;

- njëra nga palët në transaksion është një jorezident që ka një seli të përhershme në Shqipëri, së cilës i atribuohet transaksioni, dhe pala tjetër është një person tjetër jorezident;

- njëra palë në transaksion është një rezident dhe pala tjetër është një rezident që ka një seli të përhershme jashtë Shqipërisë, së cilës i atribuohet transaksioni;

ii) çdo marrëdhënie biznesi ndërmjet një jorezidenti dhe një selie të përhershme në Shqipëri të atij jorezidenti;

iii) çdo marrëdhënie biznesi ndërmjet një rezidenti dhe selisë së përhershme të tij jashtë Shqipërisë;

iv) çdo transaksion ndërmjet një rezidenti apo një jorezidenti që ka një seli të përhershme në Shqipëri, së cilës i atribuohet transaksioni, me një rezident të një juridiksioni të listuar me udhëzim të ministrit të Financave.

d) "Transaksion i pakontrolluar" është çdo transaksion ndërmjet palëve të pavarura.

dh) Termi "transaksion" përfshin një ujdj, mirëkuptim, marrëveshje apo praktikë direkte ose indirekte mes palëve, e detyrueshme ose jo ligjërishit apo me synimin që të jetë ligjërishit e detyrueshme, dhe përfshin çdo marrëdhënie biznesi ndërmjet personave të lidhur.

e) Kushtet e një transaksioni përfshijnë, por pa u kufizuar vetëm në to, treguesit financiarë të matur në aplikimin e metodës së duhur të transferimit të çmimit, p.sh., çmimi i transaksionit, marzhi bruto apo fitimi neto i përfituar nga një prej palëve në transaksion, ose ndarja e fitimit midis palëve në transaksion.

ë) "Marrëveshje çmimi në avancë" është një marrëveshje procedurale ndërmjet një apo më shumë tatimpaguesve dhe një apo më shumë administratave tatimore, me qëllim zgjidhjen në avancë të mosmarrëveshjeve të mundshme të transferimit të çmimit, duke përcaktuar, para kryerjes së transaksioneve të kontrolluara, një grup kriteresh të përshtatshme për përcaktimin e përputhshmërisë së këtyre transaksioneve me parimin e tregut.

Neni 3

Rezidenca

(Ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 8841, datë 11.12.2001 dhe pika 4 me ligjin nr. 9735, datë 17.5.2007)

Rezident në Republikën e Shqipërisë janë këta persona:

1. Individit, në rast se:
 - ka një vendbanim të qëndrueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, në kuptim të nenit 12 të Kodit Civil;
 - është shtetas shqiptar dhe funksionar konsullor, diplomatik ose i ngjashëm i Republikës së Shqipërisë, jashtë territorit të saj.
2. Individit, që, në mënyrë të vazhdueshme ose me ndërprerje, qëndron në Republikën e Shqipërisë për më tepër se 183 ditë të një periudhe tatimore.
3. Personi juridik i cili:
 - a) ka selinë qendrore (zyrën qendrore) në Republikën e Shqipërisë;
 - b) ka vendin e menaxhimit efektiv të biznesit në Republikën e Shqipërisë.
4. Personi fizik që, sipas legjislacionit tregtar, është regjistruar me këtë cilësi në organin e ngarkuar me ligj të veçantë për regjistrimin e subjekteve.

Neni 4

Burimi i të ardhurave

(Shtuar pika "i" me ligjin nr. 9161, datë 18.12.2003; ndryshuar germa "b" me ligjin nr. 9716, datë 16.4.2007; shtuar fjalët në fund të germës "gj" me ligjin nr. 10343, datë 28.10.2010; ndryshuar shkronjat "dh", "e" dhe "b" me ligjin nr. 94/2018, datë 3.12.2018)

Të ardhurat nga një burim në Republikën e Shqipërisë, pa u kufizuar vetëm në to, do të përfshijnë të ardhurat si vijon:

- a) Të ardhurat nga marrëdhënia e punës së ushtruar në Republikën e Shqipërisë;
- b) të ardhurat nga veprimtari kulturore apo sportive, si dhe nga veprimtari të tjera, personale në Republikën e Shqipërisë;
- c) të ardhurat nga veprimtaria e zhvilluar nga një person jorezident, nëpërmjet një personi me seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë;
- d) të ardhurat nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi sendet e paluajtshme, që i përfiton një person me seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë;
- dh) të ardhurat nga:
 - i) pasuria e paluajtshme, aksesorët dhe frytet e tyre, si dhe të ardhurat që rrjedhin nga të drejtat mbi pasuritë e paluajtshme që ndodhen në Republikën e Shqipërisë;
 - ii) të drejtat për shfrytëzimin e pasurive minerale, të drejtat për shfrytëzimin e pasurive hidrokarbure ose të drejta të tjera për shfrytëzimin e burimeve natyrore tokësore dhe ujore, përfshirë detin në Republikën e Shqipërisë, si dhe informacionit që u përket këtyre të drejtave;Të drejtat dhe informacioni i përmendur në nënndarjet "i" dhe "ii", më sipër, për qëllime të këtij ligji, trajtohen si pasuri e paluajtshme.
- e) të ardhurat nga tjetërsimi i:
 - i) pasurisë, të drejtave dhe informacionit të përmendur në shkronjën "dh" të këtij neni;
 - ii) aksioneve ose interesave të ngjashëm, të tillë si interesat në ortakëri ose truste, sipas përkufizimeve në legjislacionet përkatëse, kudo që ndodhen, në qoftë se, në çdo kohë gjatë 365 ditëve para tjetërsimit, këtyre aksioneve ose interesave të ngjashëm u buron më shumë se 50 përqind e vlerës direkt ose indirekt nga pasuria e paluajtshme, të drejtat ose informacioni, të

përmendura në shkronjën “dh” të këtij neni.

- ë) të ardhurat nga dividendët e shpërndarë nga një person juridik, rezident;
- f) të ardhurat nga pjesët e fitimit, të paguar nga një ortakëri rezidente;
- g) të ardhurat nga interesat e paguar nga organet e qeverisjes qendrore apo vendore ose nga një rezident i Republikës së Shqipërisë, ose që paguhet nga një jorezident, nëpërmjet një personi që ka seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë;
- gj) të ardhurat nga e drejta e autorit dhe pronësia intelektuale, qiraja dhe enfiteoza si dhe të ardhurat nga lojërat e fatit;
- h) të ardhurat e një personi joresident, të përfutuara si rezultat i shërbimeve të kryera për një person resident.
- i) të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen.

Neni 5

Periudha tatimore

Periudha tatimore fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti kalendarik.

KREU II

TATIMI MBI TË ARDHURAT PERSONALE

Neni 6

Fusha e veprimit të tatimit mbi të ardhurat personale

Tatimi mbi të ardhurat personale, që më poshtë do të quhen "të ardhura", llogaritet mbi të ardhurat e individëve.

Neni 7

Shtrirja e detyrimit

1. Individët rezidentë i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore, për të gjitha burimet e të ardhurave, sipas parashikimeve të këtij kreu.
2. Individët jorezidentë i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore, për burimet e të ardhurave, sipas parashikimeve të këtij kreu, të realizuara në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 8

E ardhura e tatueshme

(Shtuar germa “f” dhe “g” me ligjin nr. 9161, datë 18.12.2003; shtuar germa “gj” me ligjin nr. 9844, datë 17.12.2007; shtuar germa “h” me ligjin nr. 10228, datë 4.2.2010; shfuqizuar germa “gj” me ligjin nr. 177, datë 28.12.2013)

1. Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, merren si të ardhura të tatueshme:

- a) pagat dhe shpërblimet e tjera, në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës; Përfshihen të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet për marrëdhëniet e punës të zyrtarëve të konsullatave, diplomatët, ose funksionarë të ngjashëm të vendeve të tjera, si dhe të organizatave ndërkombëtare, të cilët, gjatë kryerjes së funksioneve të tyre zyrtare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me konventat ose marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkuara, ose të pranuar nga Republika e Shqipërisë apo Qeveria Shqiptare, kanë statusin e diplomatit. Nuk i nënshtrohen përjashtimeve të këtij paragrafi individët, shqiptarë apo të huaj, të cilët nuk gëzojnë statusin e diplomatit, të njohur nga konventat apo marrëveshjet ndërkombëtare për këtë qëllim;

- b) të ardhurat që rrjedhin nga fitimi i ortakut apo i aksionarit në shoqërinë tregtare;
- c) të ardhurat nga interesat bankarë apo ato të përfituara nga letrat me vlerë, me përjashtim të interesave të marra nga bonot e thesarit ose letra të tjera me vlerë të Qeverisë të emetuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji;
- ç) të ardhurat që rrjedhin nga drejta e autorit dhe pronësia intelektuale;
- d) të ardhurat nga enfiteoza, huaja dhe qiratë, me përjashtim të rasteve, kur të ardhurat janë realizuar nga zhvillimi i një veprimtarie tregtare, në kuptim të legjislacionit tregtar;
- dh) të ardhurat nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme;
- e) të ardhurat e individëve nga lojërat e fatit dhe kazinotë.
- f) të ardhurat e realizuara nga diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së kuotave ose aksioneve, që një ortak ose aksioner zotëron dhe ia shet një personi tjetër;
- g) të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë.
- gj) Shfuqizuar.
- h) të ardhurat në formë monetare për shtimin e kapitalit me burime nga jashtë shoqërisë, që nuk janë të tatuara më parë, ndërkohë që kanë qenë objekt tatimi dhe që nuk janë të shoqëruara me dokumente zyrtare, që vërtetojnë origjinën e këtyre të ardhurave. Procedurat përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Neni 8/1

Të ardhura të përjashtuara

(Shtuar me ligjin nr. 9161, datë 18.12.2003; shfuqizuar pika 5 me ligjin nr. 9326, datë 6.12.2004; shtuar pika 7 me ligjin nr. 10072, datë 9.2.2009; shtuar pika 8 me ligjin nr. 10364, datë 16.12.2010; shtuar pikat 9 dhe 10 me ligjin nr. 122, datë 20.12.2012; shtuar pika 11 me ligjin nr. 124, datë 25.4.2013; ndryshuar fjalët në fjalinë e parë dhe fjalia e parë e pikës 11 me ligjin nr. 177, datë 28.12.2013; shtuar pikat 12 dhe 13 me ligjin nr. 156, datë 27.11.2014, ndryshuar pika 11 me ligjin nr. 39/2018, datë 18 shtator 2018)

Përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat personale:

1. Të ardhurat e përfituara si rezultat i sigurimit në skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe ndihmat ekonomike për individët pa të ardhura ose me të ardhura të ulëta, sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës në fuqi.
 2. Bursat e nxënësve dhe të studentëve.
 3. Shpërblimet e marra në raste sëmundjesh, fatkeqësish, në përputhje me dispozitat e legjislacionit përkatës në fuqi.
 4. Të ardhurat e përfituara, përfshirë të ardhurat në formë monetare ose në natyrë, nga pronarët si shpërblim për shpronësimet që i bëhen nga shteti për interesa publikë.
 5. Shfuqizuar.
 6. Të ardhurat që përjashtohen në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.
 7. Të ardhurat e përfituara si rezultat i kompensimit financiar, për ish-pronarët dhe ish të dënuarit politikë.
 8. Kontributet e bëra nga punëdhënësi për sigurimin e jetës dhe të shëndetit të punëmarrësve.
 9. Përfitimet për dëmshpërblime, të marra nëpërmjet vendimeve të formës së prerë të gjykatave, si dhe kompensimet e caktuara për kostot gjyqësore.
 10. Të ardhurat e përfituara nga institucionet shtetërore për arritjet në shkencë, sport, kulturë.
 11. Të ardhurat e realizuara nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi tokën bujqësore nga një fermer i regjistruar te një fermer tjetër apo një person fizik a juridik që kryen aktivitet bujqësor. Përjashtohen, gjithashtu, rastet e kalimit të së drejtës së pronësisë brenda lidhjes gjinore burrë, grua, fëmijë, nëpërmjet dhurimit dhe/ose heqjes dorë nga pasuria, kur pasuria rrjedh nga bashkëpronësia e detyrueshme e fituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, "Për tokën", të ndryshuar.
- Këshilli i Ministrave përcakton kushtet dhe procedurën që garanton mosndryshimin e

destinacionit të tokës së blerë.

12. Kontributi i bërë nga çdo anëtar i një fondi të pensionit vullnetar deri në masën e përcaktuar në ligjin për fondet e pensionit vullnetar, si dhe kontributet e bëra nga punëdhënësi ose çdo kontribues tjetër, në emër dhe për llogari të anëtarit të fondit të pensionit vullnetar.

13. Kthimi i investimit, përfshirë fitimet nga kapitali prej investimeve të kryera me asetet e fondit të pensioneve, gjatë administrimit nga shoqëria administruese.

Neni 9

Tarifat tatimore

(Ndryshuar pika 2 dhe shfuqizuar pika 3 me ligjin nr. 9161, datë 18.12.2003; shtuar fjalët në fund të pikës 2 me ligjin nr. 10343, datë 28.10.2010; ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 156, datë 27.11.2014, ndryshuar fjalë në pikën 2 dhe shtuar pika 3 me ligjin me ligjin nr. 94/2018, datë 3.12.2018)

1. Pagat dhe shpërblimet, në lidhje me marrëdhëniet e punës aktuale, do të tatonen sipas tarifave të përshkruara në pasqyrën nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij ligji.

2. Interesat nga huat, depozitat ose kontrata të ngjashme, të ardhurat nga e drejta e autorit ose pronësia intelektuale, të ardhurat nga lojërat e fatit, si dhe të gjitha shpërblimet apo të ardhurat e tjera, që nuk parashikohen ndryshe në dispozita të tjera të këtij ligji, tatonen me 15 për qind.

3. Dividendët, të ardhurat që rrjedhin si fitim i ortakut, qoftë ky ortak i vetëm, tatonen me 8 për qind.

Neni 10

Mbledhja e tatimit

(Shtuar pika 3 me ligjin nr. 9161, datë 18.12.2003; ndryshuar me ligjin nr. 9326, datë 6.12.2004)

1. Çdo punëdhënës, që paguan një pagë a shpërblim të parashikuar në germën "a", të nenit 8 të këtij ligji, mban tatimin mbi të ardhurat personale, në përputhje me paragrafin e parë, të nenit 9 të këtij ligji, dhe e derdh tatimin e mbajtur në favor të organeve tatimore, jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës të kryerjes së pagesës.

2. Të gjithë punëdhënësit mbajnë regjistrime të pagesave të specifikuara në germën "a", të nenit 8 të këtij ligji, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

3. Të gjithë punëdhënësit dhe personat e vetëpunësuar janë të detyruar të deklarojnë tatimin mbi të ardhurat vetjake, të mbajtur në burim për punëmarrësit. Forma, përmbajtja, afatet dhe procedurat e dorëzimit të deklaratave përcaktohen në udhëzimin e Ministrit të Financave të nxjerrë në zbatim të këtij ligji.

Neni 11

Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme

(Shtuar në pikën 1 me ligjin nr. 9326, datë 6.12.2004; riformuluar me ligjin nr. 9716, datë 16.4.2007; ndryshuar fjalët në fund të pikës 1 me ligjin nr. 9844, datë 17.12.2007; ndryshuar fjalia e parë dhe zëvendësuar fjalët në pikën 3 me ligjin nr. 156, datë 27.11.2014; shtuar pika 4 me ligjin nr.105, datë 30.11.2017; ndryshuar pika 11 me ligjin nr. 39/2018, datë 18 shtator 2018)

1. Fitimi kapital i realizuar si rezultat i kalimit të së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, ndërtesë, truall dhe tokë bujqësore, tatonet me normën 15 për qind.

Shkëmbimi i truallit me sipërfaqe ndërtimi, në bazë të një kontrate shkëmbimi, nuk përbën moment për llogaritje të ndonjë fitimi kapital nga transferimi i pasurisë së paluajtshme.

2. Tatimi paguhet nga individi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit të pasurive të mësipërme, në përputhje me aktet ligjore. Pasuria e paluajtshme nuk regjistrohet, pa provuar pagimin e detyrimit pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

3. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme janë të detyruara që, brenda datës 20 të muajit pasardhës, të transferojnë për llogari të administratës tatimore tatimin e paguar, sipas

parashikimeve të këtij neni.

4. Ministri përgjegjës për financat dhe ministri apo institucioni që ka në fushën e përgjegjësive regjistrimin e pasurive të paluajtshme, përcaktojnë me udhëzim të përbashkët kushtet, procedurat dhe metodologjinë për zbatimin e këtij neni.

Neni 12

Të ardhurat e tatueshme nga veprimtaria e biznesit të vogël

(Shfuqizuar me ligjin nr. 9458, datë 21.12.2005; shtuar me ligjin nr. 9844, datë 17.12.2007; shfuqizuar nenet 12, 12/1, 12/2, 12/3, 12/4, 12/5 dhe 12/6 me ligjin nr. 177, datë 28.12.2013)

Neni 12/1

Shkalla tatimore

(Shtuar nenet me ligjin nr. 9844, datë 17.12.2007 dhe shfuqizuar me ligjin nr. 177, datë 28.12.2013)

Neni 12/2

Shpenzimet e njohura

(Shtuar me ligjin nr. 9844, datë 17.12.2007 dhe shfuqizuar me ligjin nr. 177, datë 28.12.2013)

Neni 12/3

Shpenzimet e panjohura

(Shtuar me ligjin nr. 9844, datë 17.12.2007; ndryshuar fjalët në gjuhën "U" me ligjin nr. 10072, datë 9.2.2009; shfuqizuar germa "ç" e pikës 1 me ligjin nr. 10343, datë 28.10.2010; shfuqizuar me ligjin nr. 177, datë 28.12.2013)

Neni 12/4

Mbajtja regjistrimeve

(Shtuar me ligjin nr. 9844, datë 17.12.2007 dhe shfuqizuar me ligjin nr. 177, datë 28.12.2013)

Neni 12/5

Kreditimi i tatimit

(Shtuar me ligjin nr. 9844, datë 17.12.2007 dhe shfuqizuar me ligjin nr. 177, datë 28.12.201)

Neni 12/6

Deklarimi

(Shtuar me ligjin nr. 9844, datë 17.12.2007; shtuar paragrafi në fund të pikës 1 me ligjin nr. 10228, datë 4.2.2010 dhe shfuqizuar me ligjin nr. 177, datë 28.12.2013)

Neni 13

Deklarata individuale vjetore e të ardhurave

(Ndryshuar me ligjin nr. 9326, datë 6.12.2004; shfuqizuar pika 3 dhe 4 me ligjin nr. 9458, datë 21.12.2005; ndryshuar me ligjin nr. 10343, datë 28.10.2010; ndryshuar me ligjin nr. 20, datë 1.3.2012)

1. Tatimpaguesit individë, rezidentë në Republikën e Shqipërisë, që realizojnë të ardhura të tatueshme në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore. Deklarues të të ardhurave individuale vjetore janë edhe tatimpaguesit jorezidentë, të cilët krijojnë të ardhura të tatueshme me burim në Republikën e Shqipërisë.

2. Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi.

3. Çdo deklaratë individuale vjetore e të ardhurave plotësohet me numrin e identifikimit personal në letërnjoftimin e individit, i cili shërben si kodi fiskal i individit. Edhe në rastin kur individ është person jorezident në Republikën e Shqipërisë, si kod fiskal shërben numri i identifikimit personal në letërnjoftimin e individit.

4. Përrjashtohen nga detyrimi për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës individuale vjetore të të ardhurave të gjithë individët që realizojnë të ardhura bruto vjetore nga të gjitha burimet në shumën e përgjithshme më pak se 2 000 000 (dy milionë) lekë.

5. Përveç tatimpaguesve të parashikuar në këtë nen, deklaratat vjetore e të ardhurave mund të plotësohet edhe nga persona të tjerë, që vendosin të bëjnë deklaratën, megjithëse nuk kanë detyrimin ligjor për këtë, për arsye se duan të përfitojnë nga skema e shpenzimeve të zbritshme, e parashikuar në këtë ligj, kur këta individë plotësojnë kushtet e përfitimit të zbritjes së shpenzimeve.

Neni 13/1

(Shtuar me ligjin nr. 10343, datë 28.10.2010; shtuar paragraf pas fjalisë së parë të pikës 2 me ligjin nr. 20, datë 1.3.2012)

Të dhënat që duhet të përmbajë deklaratat vjetore e të ardhurave:

1. Deklarata vjetore e të ardhurave plotësohet nga tatimpaguesi që mbart detyrimin për të deklaruar, në përputhje me nenin 13 të këtij ligji, dhe përmban të dhëna për të ardhurat bruto, për shpenzimet e zbritshme të kryera, si dhe për tatimet e paguara gjatë periudhës tatimore.

2. Deklaruesi, në rast se konstaton gabime materiale të bëra nga ai vetë gjatë plotësimit të deklaratës, ka të drejtë që, brenda 3 muajve nga data e dorëzimit të deklaratës, të bëjë korrigjimet e nevojshme.

Brenda këtij afati, individit ka të drejtë të bëjë korrigjimin e deklaratës deri në dy herë, pa u penalizuar. Nëse nga ana e tij korrigjimi brenda këtij afati tremujor ndryshon për herë të tretë, ndaj tij aplikohen sanksionet, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 115 “Plotësimi i pasaktë i deklaratës tatimore dhe kërkesa e pasaktë për rimbursim” të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Për të përfituar nga shpenzimet e zbritshme për fëmijët dhe për personat në kujdestari, të parashikuara në shkronjat “b” e “c” të pikës 1 të nenit 13/3 të këtij ligji, pjesa e deklaratës, që i përket këtyre shpenzimeve, plotësohet vetëm nga kryefamiljari.

4. Mënyra e plotësimit nga kryefamiljari e deklaratës për pjesën e shpenzimeve të zbritshme, për rastet e parashikuara në pikat 2 e 3 të këtij neni, rregullohet me udhëzim të Ministrisë të Financave.

Neni 13/2

Të dhënat për të ardhurat bruto

(Shtuar me ligjin nr. 10343, datë 28.10.2010; shtuar fjalia pas pikës 2 me ligjin nr. 20, datë 1.3.2012; shtuar germa “gj” në pikën 1 me ligjin nr. 122, datë 20.12.2012; ndryshuar shkronja “a”; shfuqizuar shkronja “gj” me ligjin nr. 156, datë 27.11.2014)

1. Tatimpaguesi, në deklaratën vjetore të të ardhurave, jep të dhëna për të ardhurat bruto, në të cilat përfshihen:

- a) Të ardhura bruto nga paga apo shpërblimet nga marrëdhëniet e punësimit për individët.
- b) të ardhurat bruto nga dividendi për pjesëmarrje në shoqëri tregtare apo nga veprimtaritë e biznesit;
- c) të ardhurat bruto nga qiraja dhe fitimet kapitale nga shitja e pasurisë së paluajtshme, në pronësi të deklaruesit;
- ç) të ardhurat bruto nga interesa bankarë;
- d) fitimi kapital neto, i krijuar nga investimet në tituj apo në pasuri të paluajtshme;
- dh) shuma bruto të fituara nga lotari apo lojëra të tjera të fatit;
- e) të ardhurat bruto nga pasuria intelektuale, licencat, të drejtat ekskluzive dhe pasuri të tjera, që

përbëhen vetëm nga të drejta dhe që nuk kanë formë fizike;

ë) fitimi kapital nga dhurimi;

f) të ardhura bruto të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

g) të ardhura bruto të tjera, të papërmendura në pikën 1 të këtij neni.

gj) Shfuqizuar.

2. Të ardhurat e përcaktuara në nenin 8/1 të këtij ligji, nuk përfshihen në të ardhurat bruto për efekt të plotësimit të deklaratës së të ardhurave. Në rast se shuma e të ardhurave të përcaktuara në pikën 1 e tejkalon masën prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh në vit, individit detyrohet të plotësojë dhe të dorëzojë deklaratën e të ardhurave individuale vjetore, vetëm nëse shuma e të ardhurave vjetore bruto, sipas pikës 1, e tejkalon shumën prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh.

Neni 13/3

Shpenzimet e zbritshme

(Shtuar me ligjin nr. 10343, datë 28.10.2010; ndryshuar me ligjin nr. 20, datë 1.3.2012; shtuar germa “ç” në pikën 1 me ligjin nr. 107, datë 28.3.2013; shfuqizuar shkronja “a” dhe “ç” në pikën 1 me ligjin nr. 156, datë 27.11.2014)

1. Tatimapaguesit, të cilët nuk janë subjekt i deklarimit, sipas pikës 4 të nenit 13 të këtij ligji, por duan të plotësojnë deklaratën në bazë të pikës 5 të nenit 13 të këtij ligji, dhe kanë të ardhura bruto vjetore nga të gjitha burimet deri në shumën 1 050 000 (një milion e pesëdhjetë mijë) lekë në vit (e indeksueshme çdo vit), por jo më të lartë se kjo shumë, mund të jenë subjekte deklaruese. Për efekt të llogaritjes së të ardhurës së tatueshme të këtyre individëve që plotësojnë deklaratën vjetore të të ardhurave, sipas pikës 5 të nenit 13 të këtij ligji, janë shpenzime të zbritshme shpenzimet e mëposhtme:

a) Shfuqizuar

b) shuma e interesit bankar të kredisë së marrë për shkollim, për vete apo për fëmijët dhe personat në kujdestari;

c) shpenzimet për mjekim, për vete apo për fëmijët dhe personat në kujdestari, për pjesën e pambuluar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor, sipas përcaktimeve të rregulluara me vendim të Këshillit të Ministrave.

ç) Shfuqizuar

2. Personat jorezidentë nuk përfitojnë nga e drejta e llogaritjes së shpenzimeve të zbritshme, të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 13/4

Shkalla tatimore

(Shtuar me ligjin nr. 10343, datë 28.10.2010 dhe shfuqizuar me ligjin nr. 177, datë 28.12.2013)

Neni 13/5

Mbajtja e dokumentacionit

(Shtuar me ligjin nr. 10343, datë 28.10.2010; shfuqizuar një fjali në pikën 1 me ligjin nr. 20, datë 1.3.2012)

1. Për çdo të ardhur dhe shpenzim, të referuar në deklaratën vjetore të të ardhurave, tatimpaguesi që bën deklaratën mban kopje origjinale të dokumentit që provon të ardhurën apo shpenzimin e zbritshëm ose fotokopje të njësuara nga institucioni lëshues i dokumentit. Originali i tyre, në çdo rast, ruhet në përputhje me legjislacionin fiskal dhe vihet në dispozicion të administratës tatimore, kur kërkohet prej saj.

2. Afati i ruajtjes së dokumentacionit nga individët deklarues është ai i përcaktuar në ligjin për procedurat tatimore.

Neni 13/6

Tatimi për t'u paguar

(Shtuar me ligjin nr. 10343, datë 28.10.2010; ndryshuar pika 1 dhe fjalët në pikën 2 me ligjin nr. 20, datë 1.3.2012; ndryshuar me ligjin nr. 156, datë 27.11.2014)

1. Diferenca ndërmjet totalit të të ardhurave bruto me shpenzimet e zbritshme, sipas nenit 13/3 të ligjit, dhe të ardhurat nga punësimi përbën të ardhurën e tatueshme të individit.

2. Kjo e ardhur e tatueshme tatohet sipas shkallës tatimore në përputhje me normat tatimore, të përcaktuara në nenet 9 dhe 11, me përjashtim të të ardhurave nga punësimi, të deklaruara dhe të tatuara nga punëdhënësi me tarifat progresive, sipas këtij ligji.

3. Shumës së tatimit, të llogaritur sipas pikës 2, të këtij neni, i shtohet tatimi i llogaritur mbi pagën dhe i zbriten tatimet e paguara gjatë periudhës tatimore, të dokumentuara nga mbajtësi në burim i këtyre tatimeve.

4. Për të ardhurat individuale me burime jashtë Shqipërisë, të cilat janë tatuar në vendin ku janë realizuar ato të ardhura, do të lejohet kreditimi i tatimit të huaj në përputhje me nenin 37 të ligjit.

5. Plotësimi dhe paraqitja e deklaratës vjetore individuale të të ardhurave në administratën tatimore bëhet jo më vonë se data 30 prill e çdo viti për të ardhurat e realizuara në vitin paraardhës. Nëse tatimpaguesi rezulton me pagesë, pagesa e tatimit kryhet jo më vonë se data 30 prill.

Nëse diferenca sipas pikës 2 është negative, administrata tatimore i kthen individit deklarus shumën e tatimit të paguar më tepër ose, me pëlqimin e tij, kjo shumë mund të përllogaritet si pagesë e kryer për vitin tatimor vijues.

Neni 13/7

Dorëzimi i deklaratës

(Shtuar me ligjin nr. 10343, datë 28.10.2010)

1. Deklarata dorëzohet në drejtorinë tatimore rajonale më të afërt me vendbanimin e tatimpaguesit, dorazi, me postë apo në rrugë elektronike.

2. Deklarata hartohet sipas formularit të miratuar me udhëzim të Ministrit të Financave.

Neni 13/8

Afatet e ekzekutimit të kreditimit

(Shtuar me ligjin nr. 10343, datë 28.10.2010; ndryshuar fjalë me ligjin nr. 20, datë 1.3.2012)

Kreditimi i shumave të përfituara nga skema e shpenzimeve të zbritshme, e parashikuar në nenin 13/3 të këtij ligji, kryhet brenda datës 30 shtator të vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën është hartuar deklarata.

Neni 13/9

Mosplotësimi në kohë apo plotësimi i pasaktë i deklaratës tatimore vjetore të të ardhurave

(Shtuar me ligjin nr. 10343, datë 28.10.2010)

1. Kur administrata tatimore konstaton raste të mosplotësimit në kohë të deklaratës vjetore të të ardhurave, zbatohen sanksionet administrative, të përcaktuara në ligjin e procedurave tatimore, për dorëzim.

2. Në rast kur tatimpaguesi, në deklaratën vjetore të të ardhurave, jep informacion të gabuar apo të rremë e të pakorrigjuar nga ai vetë, brenda afatit të parashikuar nga ky ligj për korrigjimin, zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe të Kodit Penal.

Neni 13/10

Udhëzimi i deklaratës vjetore

(Shtuar me ligjin nr. 10343, datë 28.10.2010)

1. Ministri i Financave, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nxjerr udhëzim për zbatimin e neneve 13 deri në 13/9 të këtij ligji.

2. Këshilli i Ministrave, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nxjerr vendim për zbatimin e nenit 13/3 të këtij ligji.

Neni 14

Kundërvajtjet administrative

(Ndryshuar me ligjin nr. 8711, datë 15.12.2000; shtuar germa "e", "ë" dhe "f" me ligjin nr. 9161, datë 18.12.2003; ndryshuar me ligjin nr. 9943, datë 26.6.2008)

Shkeljet e dispozitave për tatimin mbi të ardhurat personale, që përbëjnë kundërvajtje administrative, përcaktohen në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Neni 15

Sanksionet

(Ndryshuar me ligjin nr. 8711, datë 15.12.2000; shtuar germa "d", "dh" dhe "e" me ligjin nr. 9161, datë 18.12.2003; ndryshuar germa "d" me ligjin nr. 9716, datë 16.4.2007; ndryshuar me ligjin nr. 9943, datë 26.6.2008)

Dënimet administrative për kundërvajtjet për tatimin mbi të ardhurat personale përcaktohen në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

KREU III

TATIMI MBI FITIMIN

Neni 16

Fusha e veprimit të tatimit mbi fitimin

(Shtuar fjalët në germën "a" të pikës 1 me ligjin nr. 8841, datë 11.12.2001; ndryshuar germa "a" e pikës 1 me ligjin nr. 8979, datë 12.12.2002; ndryshuar germa "c" e pikës 1 dhe pika 2 me ligjin nr. 10228, datë 4.2.2010; ndryshuar fjalët me ligjin nr. 177, datë 28.12.2013, shtuar shkronja "ç" në pikën 1 me ligjin me ligjin nr. 94/2018, datë 3.12.2018)

1. Tatimit mbi fitimin i nënshtrohen këta persona:

a) Personat juridikë dhe ortakëritë të parashikuara në nënparagrafët "iii" dhe "iv" të shkronjës "b" të pikës 1 të nenit 2 dhe që janë të regjistruar për TVSH-në.

b) Personat juridikë, ortakëritë apo bashkimet e tjera të personave të themeluara ose të organizuara në bazë të një ligji të huaj dhe që ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë.

c) Çdo person tjetër, pavarësisht nga statusi ose forma ligjore e regjistrimit apo e njohjes së tij, kur ky është subjekti i tatimit mbi vlerën e shtuar, me përjashtim të rastit kur ky person është subjekti i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël.

ç) çdo person joresident që nuk parashikohet nga shkronjat "a", "b" ose "c", të kësaj pike, dhe që nuk i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat.

2. Çdo person, sipas kuptimit të këtij ligji, pavarësisht nga statusi ose forma ligjore e regjistrimit apo e njohjes së tij, kur është a bëhet subjekti i tatimit mbi fitimin, ka të drejtë të kërkojë çregjistrimin në çdo kohë, por jo të kalojë si subjekti, që i nënshtrohet i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël.

Neni 17
Detyrimi për të paguar

1. Tatimpaguesit rezidentë i nënshtrohen tatimit mbi fitimet e realizuara nga të gjitha burimet, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Tatimpaguesit jorezidentë i nënshtrohen tatimit mbi fitimet e realizuara nga të gjitha të ardhurat, me burim në Republikën e Shqipërisë.

Neni 18
Përrjashtimet

(Shtuar germa “e” dhe “ë” me ligjin nr. 9326, datë 6.12.2004; shtuar paragrafi i fundit me ligjin nr. 9458, datë 21.12.2005; shtuar shkronja “f”; zëvendësuar fjalët në paragrafin e fundit me ligjin nr. 156, datë 27.11.2014; (shtuar shkronja “g”, ndryshuar fjalë në fjalinë e fundit me ligjin nr.105, datë 30.11.2017)

Përrjashtohen nga tatimi mbi fitimin:

- a) organet e qeverisjes qendrore dhe vendore;
 - b) Banka e Shqipërisë;
 - c) personat juridikë që ushtrojnë vetëm veprimtari të karakterit fetar, humanitar, bamirës, shkencor apo edukativ, pasuria apo fitimi i të cilëve nuk përdoret për përfitimin e organizuesve apo anëtarëve të tyre;
 - ç) organizatat e punës apo dhomat e tregtisë, industrisë ose bujqësisë, pasuria apo fitimi i të cilave nuk përdoret për përfitimin e një individi apo të një anëtari të tyre;
 - d) organizatat ndërkombëtare, agjencitë e bashkëpunimit teknik dhe përfaqësitë e tyre, përjashtimi nga tatimet i të cilave parashikohet nga marrëveshje të veçanta;
 - dh) personat e parashikuar në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi.
 - e) fondacionet ose institucionet financiare jobankare, të krijuara ose të transferuara me vendim të Këshillit të Ministrave, që kanë për qëllim mbështetjen e politikave zhvilluese të Qeverisë nëpërmjet dhënies së kredive;
 - ë) shtëpitë filmike, të prodhimit kinematografik, të licencuara dhe të subvencionuara nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë.
 - f) Fondi i pensionit vullnetar i administruar nga shoqëria administruese e fondeve të pensionit vullnetar.
 - g) strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”. Përrjashtimi nga tatimi mbi fitimin, i parashikuar sipas këtij paragrafi, aplikohet për një periudhë 10-vjeçare për ato struktura, të cilat përfitojnë statusin special deri në dhjetor 2024. Efektet e përrjashtimit fillojnë në momentin e fillimit të veprimtarisë ekonomike të strukturës akomoduese, por jo më vonë se 3 vjet nga marrja e statusit special.
- Të gjitha subjektet e përmendura në shkronjën "a" deri në shkronjën “g” të këtij neni, pavarësisht nga përrjashtimi nga pagimi i tatimit mbi fitimin, janë të detyruara të dorëzojnë në organet tatimore deklaratën tatimore dhe bilancin kontabël vjetor, në të njëjtat afate si subjektet, që i nënshtrohen tatimit mbi fitimin.

Neni 19
Fitimi i tatueshëm
(Ndryshuar fjalët me ligjin nr. 10072, datë 9.2.2009)

Fitimi i tatueshëm për periudhën tatimore përcaktohet në bazë të bilancit dhe të anekseve të tij, që duhet të jenë në përputhje me ligjin “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me dispozitat e këtij ligji, si dhe me aktet nënligjore të nxjerra nga Ministria e Financave për këtë qëllim.

Neni 20 Shpenzime të njohura

(Shtuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 9161, datë 18.12.2003; shtuar paragrafët me ligjin nr. 9716, datë 16.4.2007; shtuar paragrafi me ligjin nr. 10364, datë 16.12.2010; shfuqizuar paragrafi i pestë me ligjin nr. 20, datë 1.3.2012; shtuar paragrafi i fundit me ligjin nr. 122, datë 20.12.2012; shtuar paragrafi i fundit me ligjin nr. 156, datë 27.11.2014, shfuqizuar paragrafi i tretë dhe i katërt me ligjin nr.39/2018, datë 18 shtator 2018)

Për përcaktimin e fitimit të tatueshëm në Republikën e Shqipërisë njihen si shpenzime ato që kryhen për qëllime fitimi, sigurimi dhe ruajtje të fitimit, në masën që këto shpenzime provohen dhe dokumentohen nga tatimpaguesi, si dhe kur janë objekt i kufizimeve të specifikuara nga ky ligj.

Dokumenti i përdorur si bazë për justifikimin e shpenzimit, për efekt tatimor, është fatura tatimore me TVSH, fatura e thjeshtë tatimore dhe çdo dokument tjetër i përpiluar dhe i lëshuar, në përputhje me udhëzimet e Ministrit të Financave, në zbatim të legjislacionit tatimor.

Shfuqizuar.

Shfuqizuar.[†]

Shfuqizuar.

Shpenzimet e sigurimit të jetës dhe të shëndetit të punëmarrësve nga punëdhënësi konsiderohen si shpenzime të njohura.

Bursat që u jepen nxënësve dhe studentëve nga institucionet arsimore, publike dhe jopublike, njihen si shpenzim i zbritshëm deri në masën e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, me kusht që institucionet arsimore publike dhe jopublike, në fillim të vitit shkollor, të paraqesin pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës numrin dhe shumën e bursave.

Shpenzimet për kontributet e bëra nga punëdhënësi në interes të punëmarrësve të tij në një plan pensioni profesional, deri në shumën e përcaktuar me ligjin nr. 10 197, datë 10.12.2009, “Për fondet e pensionit vullnetar”, për çdo punëmarrës, konsiderohen shpenzime të njohura.

Neni 21 Shpenzime të panjohura

(Ndryshuar germa “h” me ligjin nr. 8841, datë 11.12.2001; ndryshuar germa “h”, “k” dhe shtuar germa “ll” me ligjin nr. 9161, datë 18.12.2003; ndryshuar germa “ë” e pikës 1 dhe pika 2, shtuar germa “m” me ligjin nr. 9326, datë 6.12.2004; ndryshuar germa “h” dhe “j” e pikës 1 dhe fjalia e fundit në pikën 2 dhe shtuar gjerat “n”, “nj” dhe “o” me ligjin nr. 9766, datë 9.7.2007; shfuqizuar germa “o” e pikës 1 me ligjin nr. 9844, datë 17.12.2007; ndryshuar fjalët e germës “nj” të pikës 1 dhe të pikës 3 me ligjin nr. 10072, datë 9.2.2009; shfuqizuar germa “d” e pikës 1 me ligjin nr. 10343, datë 28.10.2010; ndryshuar germa “ll” me ligjin nr. 107, datë 28.3.2013; shtuar fjalia në shkronjën “m” me ligjin nr. 156, datë 27.11.2014, shtuar pika 4 me ligjin nr. 129/2016, datë 15.12.2016, shtuar pika “o” e pikës 1 me ligjin nr. 94/2018, datë 3.12.2018)

1. Për efekt të përcaktimit të fitimit të tatueshëm, nuk njihen shpenzimet si vijon:
 - a) Kostoja e blerjes dhe e përmirësimit të tokës dhe të truallit;
 - b) kostoja e blerjes, përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të aktiveve të veprimtarisë, të cilat amortizohen, në përputhje me nenin 22 të këtij ligji;
 - c) zmadhimi i kapitalit themeltar të shoqërisë ose i kontributit të së cilit person në ortakëri;
 - ç) vlera e shpërblimeve në natyrë;
 - d) Shfuqizuar.
 - e) dividendët e deklaruar dhe ndarjet e fitimit për ortakët apo aksionerët e shoqërive tregtare, si dhe fitimet në rastet e ortakërisë;

[†] Shfuqizimet e paragrafit të tretë dhe të katërt hyjnë në fuqi më 1 janar 2019.

ë) interesat e paguar, të cilët tejkalojnë normën mesatare të interesit 12-mujor të kredisë për tregun bankar, sipas publikimit zyrtar të Bankës së Shqipërisë;

f) gjobat, kamatëvonesat dhe kushtet e tjera penale;

g) krijimi ose rritja e rezervave dhe e fondeve të tjera, speciale, përveç rasteve të parashikuara në ligj apo në akte nënligjore;

gj) tatimi mbi të ardhurat personale, akciza, tatimi mbi fitimin dhe tatimin mbi vlerën e shtuar, të zbritshëm;

h) shpenzimet për përfaqësim dhe shpenzimet për pritje-përcjellje, të cilat tejkalojnë shumën 0,3 për qind të qarkullimit vjetor;

i) shpenzimet e konsumit personal, të përcaktuara nga ministri i Financave;

j) shpenzimet, të cilat tejkalojnë kufijtë e përcaktuar me ligj apo me akte të tjera nënligjore. Për kufijtë e përcaktuar në ligjin nr.7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, për qëllime tatimore, nuk njihen si shpenzime të zbritshme shumat e sponsorizuara, që tejkalojnë masën 3 për qind të fitimit para tatimit dhe shuma e sponsorizuar për botuesit e shtypit, e cila tejkalon masën 5 për qind të fitimit para tatimit;

k) shpenzimet për dhurata;

l) çdo shpenzim, masa e të cilit nuk vërtetohet me dokumente nga tatimpaguesi.

ll) shpenzimet për shërbime teknike, konsulence dhe të menaxhimit, të faturuara nga persona të tretë, për të cilat nuk është paguar tatimi në burim, brenda periudhës tatimore nga tatimpaguesi.

m) humbjet, dëmtimet, frotot dhe skarcot gjatë prodhimit, tranzitimit dhe magazinimit, tej normave të përcaktuara në akte të veçanta, ligjore dhe nënligjore. Brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Ministrave përcakton me vendim normativat për frotot, humbjet, dëmtimet dhe skarcot gjatë prodhimit, magazinimit dhe transportimit etj., të njohura për qëllime fiskale.

n) shpenzimet për paga, shpërblime dhe çdo formë tjetër e të ardhurave personale, të cilat lidhen me marrëdhëniet e punësimit, që u janë paguar të punësuarve, përfshirë edhe administratorët, pa kaluar nëpërmjet sistemit bankar.

Këshilli i Ministrave përcakton me vendim rastet e përjashtimit nga ky rregull;

nj) shumat e paguara në cash, mbi kufijtë e përcaktuar në ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

o) shpenzimet për dieta që tejkalojnë 50 për qind të fondit të pagës bruto vjetore.

2. Nëse gjatë periudhës tatimore, huaja dhe parapagimi tejkalojnë mesatarisht katër herë shumën e kapitaleve të veta, interesi i paguar për shumën e tejkualuar nuk njihet si shpenzim i zbritshëm. Ky kufizim nuk zbatohet për bankat, shoqëritë e sigurimeve dhe kompanitë e leasing-ut.

3. Në rastin e personave juridikë, që nuk janë themeluar sipas ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, paragrafi i dytë i këtij neni zbatohet në të njëjtën mënyrë, si edhe për subjektet e tjera të parashikuara në këtë nen.

4. Përveç sa parashikohet në pikat 2 dhe 3, të këtij neni, në rastet e kredive, të huamarrjes ose financimeve nga personat e lidhur, nuk njihen si shpenzime të zbritshme të periudhës tatimore teprica e shpenzimit të interesit neto që tejkalon 30 për qind të fitimit të tatueshëm para interesit, tatimit, zhvlerësimit dhe amortizimit (EBITDA). Fitimi i tatueshëm para interesit, tatimit, zhvlerësimit dhe amortizimit përcaktohet në përputhje me nenin 19 të këtij ligji.

Me termin “Tepriçë të shpenzimit të interesit neto” nënkuptohet teprica që del nga diferenca e shpenzimeve të interesit me të ardhurat nga interesi.

Çdo shpenzim interesi, që nuk zbritet sipas kësaj pike, mbartet në periudhat e ardhshme tatimore, përveç nëse 50 për qind të aksioneve ose të të drejtave të votës në shoqëri janë transferuar.

Përcaktimet e këtij paragrafi nuk zbatohen për bankat, institucionet financiare jobankare të kredidhënies, shoqëritë e sigurimeve dhe kompanitë e leasing-ut.

Rregullat për zbatimin e këtij paragrafi përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Neni 22 Amortizimi

(Ndryshuar pika 4 me ligjin nr. 9458, datë 21.12.2005; ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 10228, datë 4.2.2010; shtuar paragrafi në pikën 3; ndryshuar pika 5 me ligjin nr. 156, datë 27.11.2014)

1. Në përcaktimin e fitimit të tatueshëm, amortizimi për aktivet e veprimtarisë llogaritet nga:
 - a) pronari i aktiveve të veprimtarisë, në të gjitha rastet, përveç atyre të përmendura në shkronjën "b" të këtij neni;
 - b) në rastet e aktiveve të dhëna me qira, me huapërdorje ose në një formë tjetër, të parashikuara me dispozita ligjore, nga personi që mbart riskun për humbjen apo shkatërrimin e aktivitetit.
2. Toka, trualli, veprat e artit, sendet antike, bizhuteritë, metalet dhe gurët e çmuar nuk amortizohen.
3. Kostot e blerjes ose të ndërtimit, kostot e përmirësimit, të rinovimit e të rikonstruksionit të ndërtesave, të konstruksioneve dhe makinerive e pajisjeve me afat të gjatë shërbimi, amortizohen veçmas, me vlerën e mbetur, me 5 për qind.
Në rastin kur vlera e mbetur e aktivitetit në fillim të periudhës tatimore është më e vogël se 3 për qind e kostos historike të këtij aktiviteti, atëherë kjo vlerë e mbetur do të njihet tërësisht si shpenzim i zbritshëm i periudhës tatimore.
4. Amortizimi për kostot e blerjes së aktiveve të patrupëzuara llogaritet veç për secilin aktiv, sipas metodës lineare, në masën 15 për qind.
5. Dy kategoritë e mëposhtme të aktiveve amortizohen me metodën e vlerës së mbetur, në bazë të një sistemi grupimi, me përqindje si më poshtë:
 - a) Kompjuterë, sisteme informacioni, produkte "software" dhe pajisje të ruajtjes së të dhënave me 25 për qind.
 - b) Të gjitha aktivet e tjera të veprimtarisë me 20 për qind.Në rastin kur vlera e mbetur e aktivitetit në fillim të periudhës tatimore është më e vogël se 10 për qind e kostos historike të këtij aktiviteti, atëherë kjo vlerë e mbetur do të njihet tërësisht si shpenzim i zbritshëm i periudhës tatimore.
6. Në çdo kategori, të përshkruar në paragrafin e pestë të këtij neni, përqindja e amortizimit, e specifikuar në këtë pikë, zbatohet mbi bazën e amortizimit të kategorisë përkatëse.
7. Baza e amortizimit të jetë vlera kontabël e kategorisë së regjistruar në bilancin e hapjes së periudhës tatimore:
 - a) duke i shtuar koston e blerjes apo të krijimit të aktivitetit dhe koston e përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të aktiveve të kategorisë gjatë periudhës tatimore;
 - b) duke i zbritur çmimin e shitjes së aktiveve dhe kompensimet e marra për humbjen e aktiveve, për shkak të forcave të tjera madhore ose të shndërrimeve të tjera, të pavullnetshme gjatë periudhës tatimore.Në rastin kur baza e amortizimit është një shumë negative, kjo shumë i shtohet fitimit të tatueshëm dhe baza e amortizimit merret zero.
Në rastin kur baza e amortizimit nuk kalon 5 000 lekë, e gjithë baza e amortizimit të jetë një shpenzim i zbritshëm veprimtarie.
Në rastin kur bëhet rivlerësim i aktiveve të veprimtarisë nuk lejohet të llogaritet amortizimi për shumën e rivlerësuar.

Neni 23

Inventari

(Ndryshuar me ligjin nr. 9458, datë 21.12.2005; ndryshuar me ligjin nr. 10072, datë 9.2.2009)

Njohja fillestare (me kosto) dhe vlerësimi i inventarit, në fund të periudhës tatimore, bëhen sipas metodave të përcaktuara në ligjin "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të cilat duhet të zbatohen në mënyrë sistematike.

Zhvlerësimi dhe rivlerësimi i inventarit, pas njohjes fillestare, sipas përcaktimeve të ligjit të mësipërm, nuk njihen për efekt të llogaritjes së fitimit të tatueshëm. Ky rregull zbatohet edhe për aktivet financiare dhe aktivet jomateriale.

Neni 24

Borxhet e këqija

(Shtuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 32, datë 3.4.2014, shtuar shkronja “c” me ligjin nr. 94/2018, datë 3.12.2018)

Në përcaktimin e fitimit të tatueshëm, borxhi i keq njihet si shpenzim i zbritshëm, në rast se plotësohen, njëkohësisht, tri kushtet e mëposhtme:

- a) Një shumë, që korrespondon me këtë borxh, është përfshirë më parë në të ardhurat;
- b) borxhi është fshirë nga librat kontabël të tatimpaguesit;
- c) janë ndërmarrë të gjitha veprimet e mundshme ligjore për arkëtimin e tij.

Në rastin e bankave, degëve të bankave të huaja dhe subjekteve financiare jobanka, të licencuara nga Banka e Shqipërisë për ushtrimin e veprimtarisë së kredidhënies, në përcaktimin e fitimit të tatueshëm, fshirja e borxhit të keq, lidhur me procesin e kredidhënies, njihet si shpenzim i zbritshëm me plotësimin e këtyre afateve:

- a) 365 ditë pas depozitimit të kërkesës për fillimin e procedimit të ekzekutimit të detyrueshëm të përmbaruesi, në rast se kredia është e siguruar me pasuri të luajtshme ose të paluajtshme;
- b) 365 ditë pas lëshimit nga gjykata të urdhrimit të ekzekutimit, në rast se kredia nuk është e garantuar me pasuri të luajtshme ose të paluajtshme.
- c) në rast se pasuria e luajtshme ose e paluajtshme që siguron kredinë, ekzekutohet para afateve të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” më lart, provizionet e mëparshme bankare, të njohura si shpenzime të zbritshme, do të vazhdojnë të njihen si të tilla.

Neni 25

Rezervat speciale për bankat dhe shoqëritë e sigurimit

(Ndryshuar fjalët me ligjin nr. 10072, datë 9.2.2009; ndryshuar me ligjin nr. 10364, datë 16.12.2010; shfuqizohen fjalët me ligjin nr. 177, datë 28.12.2013; shtuar një paragraf me ligjin me ligjin nr. 129/2016, datë 15.12.2016)

Në përcaktimin e fitimit të tatueshëm të bankave dhe të shoqërive të sigurimit janë shpenzime të njohura rezervat teknike, të krijuara në përputhje me ligjin “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime” dhe provizionet e bankave, të krijuara në përputhje me standardet e hartuara nga Bordi i Standardeve Kontabël Ndërkombëtare dhe të certifikuara pa vërejtje nga auditues të jashtëm. Shumat e rimarra nga këto rezerva apo provizione i shtohen fitimit të tatueshëm.

Shpenzimet e bankave për kontributet vjetore dhe të jashtëzakonshme, në përputhje me ligjin “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë”, janë shpenzime të njohura në përcaktimin e fitimit të tatueshëm.

Neni 26

Pjesëmarrjet që përjashtohen nga tatimi mbi fitimin

(Ndryshuar me ligjin nr. 10072, datë 9.2.2009; ndryshuar me ligjin nr. 10364, datë 16.12.2010)

Në përcaktimin e fitimit të tatueshëm të një personi rezident përjashtohen, si të ardhura, dividendët dhe ndarjet e fitimit, kur ato shpërndahen nga shoqëritë e ortakëritë rezidente dhe shoqëritë jorezidente të huaja, që janë subjekte të tatimit mbi fitimin, pavarësisht nga kuota e pjesëmarrjes, në vlerë ose në numër, të kapitalit aksionar, të së drejtës së votës apo të pjesëmarrjes në kapitalin fillestar apo aksionar të përfituesit.

Neni 27

Mbartja e humbjeve

(Ndryshuar fjalët në pikën 2 me ligjin nr. 122, datë 20.12.2012)

1. Në rast se fitimi i tatueshëm në një periudhë tatimore rezulton negativ, humbjet e rezultuara mund të mbulohen me fitimet në tri periudhat e ardhshme tatimore, sipas parimit "humbja e parë më përpara se ajo e fundit".

2. Në rast se gjatë një periudhe tatimore pronësia e drejtpërdrejtë dhe/ose e tërthortë e kapitalit themeltar ose e të drejtave të votës, të një personi, ndryshon me më shumë se 50 për qind, në vlerë ose në numër, paragrafi i mësipërm nuk zbatohet për humbjet e pësuar nga ai person juridik, në atë periudhë tatimore dhe në periudhat paraardhëse të tatimit.

Neni 27/1

Ndryshimi i pronësisë

(shtuar me ligjin nr. 94/2018, datë 3.12.2018)

1. Nëse gjatë një periudhe tatimore pronësia direkte dhe/ose indirekte e kapitalit aksionar, kuotave, ose e të drejtave të votimit të një personi juridik ndryshon me më shumë se 20 % në vlerë ose numër aksionesh, kuotash, personi juridik trajtohet si të jetë duke shitur një pjesë proporcionale të të gjitha pasurive të tij menjëherë përpara ndryshimit. Personi juridik trajtohet si:

a) përfitues i të ardhurave nga shitja, e barabartë kjo me pjesën proporcionale të vlerës së tregut të aktivitetit në atë kohë; dhe

b) riblerës i aktivitetit për të njëjtën vlerë.

Pika 1 aplikohet në rastet kur personi juridik, për tre vitet paraardhëse, ka realizuar një mesatare qarkullimi prej 500 000 000 (pesëqind milionë) lekësh.

2. Kur një person juridik paguan tatimin mbi fitimin, sipas këtij ligji, bazuar në pikën 1, të këtij neni, çdo ndryshim pronësie i aksioneve ose interesave të ngjashëm që shkaktojnë ndryshimin është i përjashtuar nga tatimi mbi fitimin.

3. Një person juridik, i cili është subjekt i një ndryshimi të përmendur në pikën 1, të këtij neni, duhet të njoftojë autoritetet tatimore me detajet e ndryshimit brenda 45 ditëve nga koha kur ka ndodhur ndryshimi.

4. Personi juridik duhet të njoftojë administratën tatimore për një ndryshim pronësie të drejtpërdrejtë ose të tërthortë prej 10 % ose më shumë të kapitalit të saj ose të të drejtave të votës. Ndryshimi i pronësisë duhet të jetë objekt i nënndarjes "ii", të shkronjës "e", të nenit 4, të këtij ligji. Njoftimi duhet të kryhet brenda 45 ditëve nga ndryshimi i pronësisë. Kjo dispozitë nuk zbatohet në rastet kur zbatohet pika 3 e këtij neni.

5. Në rast të mosnjoftimit të autoriteteve tatimore, personi juridik dënohet sipas penaliteteve të përcaktuara në ligjin "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Neni 28

Shkalla tatimore

(Ndryshuar me ligjin nr. 8711, datë 15.12.2000; ndryshuar me ligjin nr. 9326, datë 6.12.2004; ndryshuar me ligjin nr. 9458, datë 21.12.2005; ndryshuar me ligjin nr. 9766, datë 9.7.2007; ndryshuar me ligjin nr. 177, datë 28.12.2013; ndryshuar me ligjin nr.105, datë 30.11.2017; ndryshuar pika 1 dhe shtuar pikat 3 dhe 4 me ligjin nr. 39/2018, datë 18 shtator 2018)

1. Shkalla e tatimit mbi fitimin është:

- 5 % për tatimpaguesit me të ardhura deri në 14 000 000 lekë në vit.

- 15 % për tatimpaguesit me të ardhura mbi 14 000 000 lekë në vit.

2. Për personat juridikë, të cilët ushtrojnë aktivitetet për prodhimin/zhvillimin e software-ve, tatimi mbi fitimin është 5 %. Këshilli i Ministrave përcakton, me vendim, aktivitetet që përfshihen në fushën e prodhimit/zhvillimit të software-ve, si dhe procedurat për zbatimin e këtij paragrafi.

3. Për personat juridikë, të cilët zhvillojnë veprimtari ekonomike sipas ligjit nr. 38/2012, “Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor”, shkalla e tatimit mbi fitimin është 5 %.

4. Për subjektet, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si “agroturizëm”, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit, shkalla e tatimit mbi fitimin është 5 %. Kjo shkallë aplikohet për një periudhë 10-vjeçare për personat juridikë që përfitojnë statusin “subjekt i certifikuar agroturizmi”, deri më 31 dhjetor 2021. Aplikimi i shkallës së reduktuar fillon në vitin tatimor pasardhës, pas përfitimit të statusit “subjekt i certifikuar agroturizmi.”

Neni 29

Deklarimi tatimor dhe llogaritja përfundimtare e detyrimit

(Shtuar në fund të paragrafit të parë me ligjin nr. 8711, datë 15.12.2000; shtuar pika 4 me ligjin nr. 8979, datë 12.12.2002; ndryshuar me ligjin nr. 9161, datë 18.12.2003; shfuqizuar pika 3 me ligjin nr. 9326, datë 6.12.2004)

1. Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Për efekte fiskale, të dhënat e dokumenteve të mësipërme quhen të pranuar, kur miratohen nga administrata tatimore ose kur kalojnë dy muaj pas dorëzimit të tyre zyrtar dhe administrata tatimore nuk përgjigjet zyrtarisht.

2. Tatimi i llogaritur në bazë të deklaratës vjetore të të ardhurave të tatueshme, pakësuar me shumat e përcaktuara sipas nenit 37 të këtij ligji dhe me parapagimet e bëra gjatë periudhës tatimore, paguhet nga tatimpaguesi në llogarinë e organeve tatimore, në çastin e paraqitjes së deklaratës vjetore të të ardhurave të tatueshme.

3. Shfuqizuar.

Neni 30

Parapagimet

(Shtuar në fund të paragrafit të katërt me ligjin nr. 8841, datë 11.12.2001; ndryshuar pika 5 me ligjin nr. 10364, datë 16.12.2010; ndryshuar fjalia e parë me ligjin nr. 71, datë 28.6.2012; ndryshuar neni me ligjin nr. 83, datë 17.7.2014)

1. Gjatë periudhës vijuese tatimore, tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e organeve tatimore, këstet tremujore të tatimit mbi fitimin, brenda datës 30 mars, për muajt janar, shkurt dhe mars; brenda datës 30 qershor, për muajt prill, maj dhe qershor; brenda datës 30 shtator, për muajt korrik, gusht dhe shtator dhe, brenda datës 30 dhjetor, për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor. Këstet mund të paguhen edhe në baza mujore, jo më vonë se data 15 e çdo muaji, në shumat si më poshtë:

a) për çdonjërin nga muajt janar, shkurt dhe mars të periudhës vijuese tatimore, shumën e tatimit mbi fitimin për periudhën tatimore të dy viteve më parë pjesëtuar me 12;

b) për çdonjërin nga 9 muajt e tjerë të periudhës vijuese tatimore, shumën e tatimit mbi fitimin për periudhën paraardhëse tatimore pjesëtuar me 12.

2. Në rastin kur tatimpaguesi e fillon veprimtarinë gjatë periudhës tatimore të vitit të dytë paraardhës, parapagimet për muajt janar-mars të periudhës vijuese tatimore janë si më poshtë:

2.1 Shuma e tatimit mbi fitimin për periudhën tatimore të dy viteve më parë pjesëtuar me numrin e muajve, gjatë të cilëve tatimpaguesi ka ushtruar veprimtarinë tatimore. Për përcaktimin e parapagimeve për muajt e tjerë të periudhës vijuese tatimore, tatimi llogaritet sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij neni.

3. Në rastin kur tatimpaguesi e fillon veprimtarinë gjatë periudhës paraardhëse tatimore, parapagimet për muajt janar-mars të periudhës vijuese tatimore janë sa shumat e vlerësuar e tatimit mbi fitimin për periudhën e mëparshme, pjesëtuar me numrin e muajve të periudhës së mëparshme,

gjatë të cilëve është ushtruar veprimtari. Shkronja “b”, e pikës 1, të këtij neni, zbatohet për përcaktimin e parapagimeve për efekt të muajve të mbetur nga periudha vijuese tatimore.

4. Në rastin kur një tatimpagues fillon të ushtrorë një veprimtari në periudhën vijuese tatimore, parapagimet për këtë periudhë janë sa shuma e vlerësuar e tatimit mbi fitimin për periudhën vijuese, pjesëtuar me numrin e muajve të mbetur nga periudha vijuese tatimore. Përrjashtimisht, tatimpaguesit që fillojnë veprimtarinë në periudhën vijuese dhe ushtrorë veprimtari në sferën prodhuese nuk do t'i nënshtrohen parapagimit të detyrimit për tatimin mbi fitimin për një periudhë 6-mujore ose për periudhën e mbetur deri në fund të vitit vijues, nëse kjo periudhë është edhe më e vogël se 6 muaj.

5. Në rastin kur tatimpaguesi, në çdo kohë, gjatë periudhës tatimore, vërteton para organeve tatimore se tatimi mbi fitimin për këtë periudhë tatimore do të jetë, në mënyrë domethënëse, më i ulët se tatimi mbi fitimin në periudhën paraardhëse ose periudhën e dytë paraardhëse, atëherë organet tatimore pranojnë zvogëlimin e parapagimeve, sipas rregullave të vendosura me udhëzim të Ministrisë të Financave. Në rast se subjekti taksapagues ka ulur këstet e parapagimit, të caktuara nga organi tatimor, dhe detyrimi tatimor vjetor për tatimfitimin, që rezulton nga bilanci, tejkalon parapagimin me më shumë se 10 për qind, subjekti duhet të paguajë kamatëvonesa mbi diferencën ndërmjet detyrimit real vjetor dhe shumës së parapaguar gjatë vitit, sipas rregullave të vendosura me udhëzim të Ministrisë të Financave.

6. Nëse organet tatimore vlerësojnë se tatimi mbi fitimin për periudhën vijuese tatimore do të tejkalojë me më tepër se 10 për qind tatimin mbi fitimin e periudhës së mëparshme tatimore, ato mund të rregullojnë në rritje parapagimet, në përputhje me tatimin mbi fitimin e vlerësuar prej tyre.

Neni 30/1

Deklarimi dhe pagesa nga persona joresidentë specifike

(shtuar me ligjin nr. 94/2018, datë 3.12.2018)

1. Një personi joresident, të përcaktuar sipas shkronjës “ç”, të pikës 1, të nenit 16, të këtij ligji, i kërkohet të përgatisë një deklaratë të të ardhurave të tatueshme, sipas udhëzimit të ministrit përgjegjës për financat. Deklarata duhet të dorëzohet sipas afatit të përcaktuar në nenin 29 të këtij ligji.

2. Në kohën e paraqitjes së deklaratës, sipas pikës 1, të këtij neni, personi joresident duhet të paguajë shumën e tatimit të deklaruar. Nenet 30 dhe 37, të këtij ligji, nuk zbatohen për këto raste.

Neni 31

Kundërvajtjet administrative

(Ndryshuar me ligjin nr. 8711, datë 15.12.2000 dhe nr. 9943, datë 26.6.2008)

Shkeljet e dispozitave për tatimin mbi fitimin, që përbëjnë kundërvajtje administrative, përveç mbajtjes së gabuar të llogarive pa pasoja në rezultatin financiar 1, përcaktohen në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”

Neni 32

Sanksionet

(Ndryshuar me ligjin nr. 8711, datë 15.12.2000; shtuar germa “d” me ligjin nr. 8841, datë 11.12.2001; shtuar fjalët në germen “b” me ligjin nr. 9326, datë 6.12.2004; ndryshuar me ligjin nr. 9943, datë 26.6.2008)

1. Dënimet administrative për kundërvajtjet për tatimin mbi fitimin përcaktohen në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

2. Për rastet e shkeljeve, për mbajtje të gabuar të llogarive pa pasoja në rezultatin financiar 1, personat përgjegjës dënohen me gjobë 10 mijë lekë.

KREU III/A

TATIMI I THJESHUAR MBI FITIMIN

(Shtuar me ligjin nr. 8979, datë 12.12.2002; shfuqizuar me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 dhe me ligjin nr. 9716, datë 16.4.2007)

Neni 32/1

Fusha e veprimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin

(Ndryshuar germa "a" dhe shtuar germa "c" në pikën 2 me ligjin nr. 9161, datë 18.12.2003; shfuqizuar germa "c" e pikës 2 me ligjin nr. 9326, datë 6.12.2004; shfuqizuar me ligjin nr. 9716, datë 16.4.2007)

Neni 32/2

Regjistrimi dhe reregjistrimi

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 9326, datë 6.12.2004 dhe shfuqizuar me ligjin nr. 9716, datë 16.4.2007)

Neni 32/3

Shkalla tatimore

(Ndryshuar me ligjin nr. 9326, datë 6.12.2004; ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 9431, datë 13.10.2005 dhe shfuqizuar me ligjin nr. 9716, datë 16.4.2007)

Neni 32/4

Deklarimi

(shfuqizuar me ligjin nr. 9716, datë 16.4.2007)

Neni 32/5

Mbajtja e regjistrimeve

(Shfuqizuar me ligjin nr. 9161, datë 16.4.2007)

Neni 32/6

Pagesa

(Ndryshuar me ligjin nr. 9326, datë 6.12.2004 dhe shfuqizuar me ligjin nr. 9716, datë 16.4.2007)

Neni 32/7

Të dhënat

(shfuqizuar me ligjin nr. 9716, datë 16.4.2007)

Neni 32/8

Kundërvajtjet dhe gjobat

(Ndryshuar germa "a" dhe shtuar germa "db" në pikën 1 me ligjin nr. 9326, datë 6.12.2004 dhe shfuqizuar me ligjin nr. 9716, datë 16.4.2007)

KREU IV

TATIMI I MBAJTUR NË BURIMIN E TË ARDHURAVE

Neni 33

Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat

(Shtuar në fund të germës "d" të pikës 1 me ligjin nr. 8841, datë 11.12.2001; ndryshuar me ligjin nr. 9161, datë 18.12.2003; ndryshuar me ligjin nr. 9326, datë 6.12.2004; shfuqizuar pika 4 me ligjin nr. 9458, datë 21.12.2005; ndryshuar pika 5 me ligjin nr. 9483, datë 16.2.2006; shtuar germa "g" e pikës 1 me ligjin nr. 10343, datë 28.10.2010; ndryshuar fjalia e parë e pikës 1 me ligjin nr. 156, datë 27.11.2014, ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 94/2018, datë 3.12.2018)

1. Të gjithë personat residentë në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes qendrore e vendore, organizatat jofitimprurëse dhe çdo subjekt tjetër, i njohur nga legjislacioni në fuqi, janë të detyruar të mbajnë tatimin në burim nga shuma bruto e pagesave të mëposhtme, që lindin nga një burim në Republikën e Shqipërisë, sipas shkallëve të mëposhtme:

1.1. 15 për qind për:

- a) interesat dhe pagesat e ngjashme me to;
- b) pagesat për të drejtat e autorit dhe për pronësinë intelektuale;
- c) pagesat për shërbimet teknike, shërbimet e menaxhimit, shërbimet e konsulencës, shërbimet financiare dhe ato të sigurimit;
- ç) pagesat për menaxhimin dhe pjesëmarrjen në këshillat drejtues;
- d) pagesat për ndërtimin, instalimin, montimin ose për punë mbikëqyrëse që lidhen me to;
- dh) pagesat për qiratë;
- e) pagesat për shfaqjet e aktorëve, të muzikantëve ose sportistëve, përfshirë pagesa të tilla që u bëhen personave, të cilët punësojnë artistë ose sportistë apo ndërmjetësojnë për shfaqjet e tyre;
- ë) të ardhurat e individëve nga lojërat e fatit dhe kazinotë.

1.2. 8 për qind për:

- a) dividendët;
- b) ndarjet e fitimit.

2. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet për:

- a) personat rezidentë shqiptarë, të regjistruar si tatimpagues të tatimit mbi fitimin dhe të tatimit mbi vlerën e shtuar ose personat e regjistruar si tatimpagues të taksës vendore mbi biznesin e vogël;
- b) dividendët dhe shpërndarjet e tjera të fitimit brenda objektit të përcaktuar në nenin 26 të këtij ligji;
- c) pagesat e bëra personave jorezidentë për shërbimet për transportin ndërkombëtar të pasagjerëve dhe mallrave.

3. Përveç rasteve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, tatimi në burim i mbajtur mbi pagesën, sipas pikës 1 të këtij neni, përfaqëson detyrimin tatimor përfundimtar.

4. Shfuqizuar.

5. Agjencia Nacionale e Trafikut Ajror sh.a. (ANTA) përjashtohet nga pagimi i tatimit në burim për të ardhurat nga shërbimet navigacionale ajrore.

Neni 33/1

Depozitimi i vendimit për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimi i fitimit

(Shtuar me ligjin nr. 9458, datë 21.12.2005; ndryshuar fjalët në pikën 1 me ligjin nr. 10072, datë 9.2.2009; ndryshuar me ligjin nr. 10228, datë 4.2.2010; ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 83, datë 17.7.2014; ndryshuar fjalë në pikat 2 dhe 4 me ligji nr. 39/2018, datë 18 shtator 2018)

1. Shoqëritë tregtare, sipas ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, pas pagimit të tatimit mbi fitimin, sipas dispozitave të kreut III të këtij ligji, brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar, duhet të miratojnë në asamblenë e ortakëve apo organin kompetent vendimmarrës të shoqërisë rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe ta destinonjë fitimin pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore, pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë kapitali dhe pjesën që do të shpërndahet në formë dividendi.

2. Shoqëritë tregtare sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të depozitojnë pranë organeve tatimore, jo më vonë se data 31 korrik e vitit kalendarik, vendimin e organit përgjegjës. Për paraqitjen me vonesë të këtij vendimi zbatohet një gjobë prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh.

3. Personi juridik duhet të deklarojë dhe të paguajë për llogari të administratës tatimore tatimin mbi dividendin e pagueshëm, sipas pikës 1, të këtij neni, jo më vonë se data 20 gusht e vitit kur bëhet miratimi i rezultateve, pavarësisht nëse është bërë ose jo shpërndarja e dividendit.

4. Vendimi i asamblesë së ortakëve, i organit kompetent të shoqërisë, sipas këtij neni, për

miratimin e rezultatit dhe destinimin e fitimit pas tatimit, duhet të paraqitet në organin tatimor, në përputhje me afatin e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, edhe nëse rezultati për vitin ushtrimor ka qenë me humbje apo zero. Për mosdepozitimin e vendimit zbatohen penalitetet, sipas pikës 2 të këtij neni.

Neni 34

Mbajtja përfundimtare e tatimit

(Shtuar pika 4 me ligjin nr. 8841, datë 11.12.2001; shfuqizuar me ligjin nr. 9161, datë 16.4.2007)

Neni 35

Mbajtja e tatimit në burim, regjistrimi, deklarimi dhe pagesa

(Ndryshuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 9326, datë 6.12.2004; riformuluar me ligjin nr. 177, datë 28.12.2013)

a) Paguesi i shumave është i detyruar të mbajë regjistrime për llogaritjen dhe mbajtjen e tatimit në burim për çdo përfitues të ardhurash dhe t'i vërë ato në dispozicion të organeve tatimore dhe të personit përfitues të të ardhurave, për të cilin është bërë pagesa.

b) Paguesi i shumave, për efekt të mbajtjes së tatimit në burim, të parashikuar në nenin 33, "Depozitimi i vendimit për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimi i fitimit", është i detyruar të llogarisë, të mbajë, të deklarojë dhe të derdhë tatimin e mbajtur në burim, në llogaritë e organeve tatimore deri në datën 20 të muajit pasardhës të muajit të pagesës.

c) Ministri i Financave përcakton me udhëzim formën dhe përmbajtjen e deklaratës.

ç) Deklarata e tatimit të mbajtur në burim dorëzohet në një nga mënyrat e parashikuara në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, në drejtorinë rajonale ku është i regjistruar paguesi i shumave.

KREU V

DISPOZITA TË VEÇANTA

Neni 36

Transferimi i çmimit

(Ndryshuar me ligjin nr. 42/2014, datë 24.4.2014)

1. Nëse një tatimpagues që është subjekt i tatimit fitimit merr pjesë në një apo më shumë transaksione të kontrolluara, ai duhet të përcaktojë fitimin e tatueshëm në një mënyrë që është në përputhje me parimin e tregut.

2. Fitimet e tatueshme të një tatimpaguesi që merr pjesë në një apo më shumë transaksione të kontrolluara do të konsiderohen në përputhje me parimin e tregut, nëse kushtet e këtyre transaksioneve nuk janë të ndryshme nga kushtet që do të ishin aplikuar ndërmjet palëve të pavarura në transaksione të krahasueshme, të kryera në rrethana të krahasueshme.

3. Kur kushtet e vendosura apo të diktura në një a më shumë transaksione të kontrolluara, të kryera nga një tatimpagues, nuk janë në përputhje me parimin e tregut, atëherë fitimet e tatueshme të atij tatimpaguesi mund të rriten në atë masë që të jenë në përputhje me parimin e tregut.

4. Përcaktimi nëse kushtet e një transaksioni të kontrolluar janë në përputhje me parimin e tregut dhe masa e çdo rregullimi, sipas pikës 3 të këtij neni, do të bëhet në përputhje me dispozitat e nenit 36 të këtij ligji.

Neni 36/1

Krahasueshmëria

(Shtuar me ligjin nr. 42/2014, datë 24.4.2014)

1. Një transaksion i pakontrolluar është i krahasueshëm me një transaksion të kontrolluar, për qëllime të këtij kapitulli:

a) kur nuk ka diferenca të rëndësishme midis tyre që mund të ndikojnë materialisht treguesit

financiarë që po kontrollohen, sipas metodës së përshtatshme të transferimit të çmimit; ose

b) kur ekzistojnë të tilla diferenca, një rregullim i arsyeshëm i bëhet treguesit financiar përkatës të transaksionit të pakontrolluar, me qëllim eliminimin e efekteve të këtyre diferencave në krahasim.

2. Për të përcaktuar nëse dy apo më shumë transaksione janë të krahasueshme, do të merren në konsideratë, në masën që ata janë ekonomikisht të përshtatshëm për faktet dhe rrethanat e transaksionit, këta faktorë:

- a) karakteristikat e pronës, mallit apo shërbimeve të transferuara;
- b) funksionet e marra përsipër nga secila palë në lidhje me transaksionet, duke marrë në konsideratë asetet e përdorura dhe risqet e marra;
- c) kushtet kontraktuale të transaksioneve;
- ç) rrethanat ekonomike në të cilat ndodhin transaksionet;
- d) dhe strategjitë e biznesit të ndjekura nga palët në lidhje me transaksionet.

Neni 36/2

Metodat e transferimit të çmimit

(Shtuar me ligjin nr. 42/2014, datë 24.4.2014)

1. Përputhshmëria me parimin e tregut e një transaksioni të kontrolluar do të përcaktohet duke aplikuar metodën më të përshtatshme të transferimit të çmimit, sipas rrethanave të rastit, sipas përcaktimeve të bëra me udhëzim të ministrit të Financave. Përveç sa parashikohet në pikën 2, metoda më e përshtatshme e transferimit të çmimit do të zgjidhet midis metodave që vijojnë:

a) metoda e çmimit të pakontrolluar të krahasueshëm, e cila konsiston në krahasimin e çmimit të vendosur për mallra apo shërbime të transferuara në një transaksion të kontrolluar me çmimin e vendosur për mallra apo shërbime të transferuara në një transaksion të pakontrolluar të krahasueshëm;

b) metoda e çmimit të rishitjes, e cila konsiston në krahasimin e marzhit të rishitjes, që një blerës mallrash në një transaksion të kontrolluar fiton nga rishitja e asaj prone në një transaksion të pakontrolluar, me marzhin e rishitjes që fitohet në transaksione shitblerjesh të pakontrolluara të krahasueshme;

c) metoda kosto plus, e cila konsiston në krahasimin e rritjes (marzhit të fitimit) mbi kostot direkte dhe indirekte në furnizimin e mallrave e shërbimeve në një transaksion të kontrolluar me rritjen, marzhin e fitimit të këtyre kostove direkte dhe indirekte në furnizimin e mallrave dhe shërbimeve në një transaksion të pakontrolluar të krahasueshëm;

ç) metoda e marzhit neto të transaksionit, e cila konsiston në krahasimin e marzhit neto të fitimit ndaj një baze të përshtatshme, p.sh., kostot, shitjet, asetet, që një palë arrin në një transaksion të kontrolluar, me marzhin neto të fitimit ndaj së njëjtës baze të arritur në transaksione të pakontrolluara të krahasueshme;

d) metoda e ndarjes së fitimit të transaksionit, sipas së cilës çdo personi të lidhur që merr pjesë në një transaksion të kontrolluar i alokohet pjesa e fitimit të përbashkët/humbjes që rrjedh nga ky transaksion që një person i pavarur do të fitonte nga pjesëmarrja në një transaksion të pakontrolluar të krahasueshëm.

2. Tatimpaguesi mund të aplikojë një metodë të transferimit të çmimit të ndryshme nga metodat e mësipërme, kur ai provon se asnjë nga metodat e miratuara nuk mund të përdoret në mënyrë të arsyeshme për të përcaktuar përputhshmërinë me parimin e tregut për transaksionet e kontrolluara dhe kjo metodë tjetër jep një rezultat në përputhje me parimin e tregut. Tatimpaguesi që përdor një metodë të ndryshme nga metodat e miratuara, të përmendura në pikën 1 të këtij neni, do të ketë barrën e provës për të demonstruar se kërkesat e këtij kreu janë përmbushur.

3. Për të përcaktuar përputhshmërinë me parimin e tregut për një transaksion të kontrolluar, nuk kërkohet të aplikohet më shumë se një metodë.

4. Kur një tatimpagues ka përdorur një metodë të transferimit të çmimit për të vendosur shpërblimin e transaksioneve të tij të kontrolluara dhe kjo metodë e transferimit të çmimit është në

përputhje me dispozitat e këtij neni, atëherë kontrolli i administratës tatimore mbi faktin nëse kushtet e transaksioneve të kontrolluara të tatimpaguesit janë në përputhje me parimin e tregut, bazohet në metodën e transferimit të çmimit të aplikuar nga tatimpaguesi.

Neni 36/3

Vlerësimi i transaksioneve të kontrolluara të kombinuara

(Shtuar me ligjin nr. 42/2014, datë 24.4.2014)

Nëse një tatimpagues kryen, në rrethana të njëjta ose të ngjashme, dy ose më shumë transaksione të kontrolluara, që janë ekonomikisht të lidhura ngushtë me njëri-tjetrin ose që përbëjnë një vazhdimësi/kombinim të caktuar, në mënyrë të tillë që ato nuk mund të analizohen veçmas në mënyrë të besueshme, këto transaksione mund të kombinohen:

- a) për të kryer analizën e krahasueshmërisë, të përcaktuar në nenin 36/1; dhe
- b) për të aplikuar metodat e transferimit të çmimit, të përcaktuara në nenin 36/2.

Neni 36/4

Diapazoni i treguesve të tregut

(Shtuar me ligjin nr. 42/2014, datë 24.4.2014)

1. Diapazon tregu është një grup treguesish financiarë përkatës, p.sh., çmimet, marzhet apo pjesët e fitimit, të nxjerra nga aplikimi i metodës më të përshtatshme të transferimit të çmimit për një numër transaksionesh të pakontrolluara, ku secili është pothuajse njëlloj i krahasueshëm me transaksionin e kontrolluar, bazuar në një analizë krahasueshmërie të kryer në përputhje me nenin 36/1.

2. Një transaksion i kontrolluar ose një grup transaksionesh nuk do të jetë subjekt i rregullimeve, sipas pikës 3 të nenit 36, kur treguesi financiar përkatës, që rrjedh nga transaksioni/transaksionet i/e kontrolluar/a që po testohet/testohen sipas metodës më të përshtatshme të transferimit të çmimit, është brenda diapazonit të tregut.

3. Kur treguesi financiar përkatës, i cili rrjedh nga transaksione të kontrolluara, del jashtë diapazonit të tregut, administrata tatimore mund ta rregullojë atë sipas pikës 3 të nenit 36, dhe çdo rregullim i tillë do të jetë në mesataren e diapazonit të tregut, përveç rasteve kur administrata tatimore apo tatimpaguesi mund të vërtetojnë se rrethanat në atë rast garantojnë rregullimin në një pikë të ndryshme të gamës së tregut, sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimin e ministrit të Financave.

Neni 36/5

Informacioni mbi transferimin e çmimit

(Shtuar me ligjin nr. 42/2014, datë 24.4.2014)

1. Një tatimpagues duhet të paraqesë informacion dhe analiza të mjaftueshme për të vërtetuar se kushtet e transaksioneve të tij të kontrolluara janë në përputhje me parimet e tregut. Dokumentacioni i transferimit të çmimit duhet t'i vihet në dispozicion administratës tatimore, me kërkesë të saj, brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës së administratës tatimore. Përmbajtja dhe forma e dokumentacionit të transferimit të çmimit përcaktohen me udhëzim të ministrit të Financave.

2. Tatimpaguesit e përfshirë në transaksione të kontrolluara mbi një vlerë të përcaktuar duhet të paraqesin një njoftim/formular vjetor për transaksionet e kontrolluara. Ministri i Financave përcakton, me udhëzim, kufirin/vlerën e sipërpërmendur, formatin dhe afatin kohor për paraqitjen e informacionit mbi transaksionet e kontrolluara.

Neni 36/6

Rregullimet korresponduese

(Shtuar me ligjin nr. 42/2014, datë 24.4.2014)

Kur në kushtet e transaksioneve të kontrolluara bëhet një rregullim nga një administratë tatimore e një vendi tjetër dhe ky rregullim rezulton në taksimin në atë vend të fitimeve, për të cilat tatimpaguesi është tatuar tashmë në Shqipëri, dhe vendi që propozon rregullimin ka një marrëveshje me Shqipërinë për eliminimin e tatimit të dyfishtë, atëherë, në këto kushte, administrata tatimore e Shqipërisë, pas kryerjes së një kërkesë nga tatimpaguesi shqiptar, do të kontrollojë përputhshmërinë e atij rregullimi me parimet e tregut, siç përcaktohet në pikën 2 të nenit 36.

Nëse administrata tatimore arrin në përfundimin që rregullimi është në përputhje me parimet e tregut, ajo bën rregullimet e duhura në vlerën e tatimit që i është ngarkuar tatimpaguesit shqiptar. Procedura për kërkesën për një rregullim korrespondues, sipas këtij neni, do të përcaktohet në udhëzimin e ministrit të Financave.

Neni 36/7

Marrëveshjet e çmimit në avancë

(Shtuar me ligjin nr. 42/2014, datë 24.4.2014)

1. Një tatimpagues mund të kërkojë që administrata tatimore të hyjë në një marrëveshje çmimi në avancë për të përcaktuar një grup të përshtatshëm kriteresh për përputhshmërinë me parimin e tregut për transaksionet e ardhshme të kontrolluara për një periudhë kohore të përcaktuar.

2. Kur administrata tatimore hyn në një marrëveshje çmimi në avancë me një tatimpagues, asnjë rregullim i transferimit të çmimit nuk bëhet sipas pikës 3 të nenit 36, për transaksionet e kontrolluara që janë brenda fushës së marrëveshjes, për aq kohë sa afatet dhe kushtet e vendosura nga marrëveshja e çmimit në avancë janë plotësuar.

3. Ngarkohet ministri i Financave për nxjerrjen e një udhëzimi të posaçëm në lidhje me marrëveshjet e çmimit në avancë.

Neni 37

Kreditimi i tatimit të huaj

1. Në qoftë se gjatë periudhës tatimore një rezident nxjerr nga burime jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë fitime apo të ardhura, tatimi mbi të ardhurat personale apo tatimi mbi fitimin, i pagueshëm nga ai rezident, lidhur me këto të ardhura apo fitime duhet të reduktohen me atë masë të tatimit të pagueshëm mbi këtë të ardhur ose fitim. Masa e tatimit të huaj të pagueshëm duhet të vërtetohet me dokument autentik, të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë së Financave.

2. Reduktimi i tatimit mbi të ardhurat personale ose tatimi mbi fitimin, i dhënë në paragrafin e parë të këtij neni nuk duhet të kalojë tatimin e pagueshëm mbi fitimin apo të ardhurat nga burimi i huaj, në rast se këto të ardhura realizohen në Republikën e Shqipërisë.

3. Në rastin e një tatimpaguesi, i cili është subjekt i tatimit mbi fitimin, çdo reduktim i tatimit, i parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, kufizohet në tatimin, që do të ishte i pagueshëm në Republikën e Shqipërisë, i llogaritur sikur neni 27 i këtij ligji të zbatohet në çdo vend të huaj, në lidhje me fitimet apo humbjet e rezultuara nga burime në atë vend të huaj.

4. Reduktimi i tatimit, sipas këtij neni, duhet të llogaritet në mënyrë të veçantë, lidhur me çdo vend të huaj, nga i cili janë përfituar të ardhurat apo fitimet.

KREU VI

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 38

Dispozita kalimtare

(Ndryshuar paragrafi 6 me ligjin nr. 8711, datë 15.12.2000; shtuar pika 7 me ligjin nr. 8841, datë

11.12.2001; ndryshuar pika 7 me ligjin nr. 9804, datë 13.9.2007; ndryshuar paragrafi i fundit i pikës 7 me ligjin nr. 20, datë 1.3.2012; shtuar fjalia në pikën 7 me ligjin nr. 122, datë 20.12.2012; shtuar pika 8 me ligjin nr. 177, datë 28.12.2013; shtuar paragraf në pikën 7 me ligjin nr.105, datë 30.11.2017; ndryshuar pika 7 me ligjin nr. 39/2018, datë 18 shtator 2018, shtuar pika 9 me ligjin nr. 94/2018, datë 3.12.2018)

1. Tatimi që duhet të mbahet në përputhje edhe me paragrafin e parë dhe të dytë të nenit 10 dhe të nenit 33 të këtij ligji, do të mbahet nga pagesat e bëra pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Ndërtesat, konstruksionet dhe impiantet e blera para datës 1 janar 1999 do të amortizohen në bazë të kostos së tyre historike.

3. Aktivitetet e qëndrueshme, të patrupëzuara, të blera para datës 1 janar 1999 do të amortizohen mbi bazën e kostos së tyre historike. Nëse vlera, e mbetur kontabël, e regjistrimit të këtyre pasurive në datën 1 janar 1999 është më e vogël se 50 për qind e kostos së tyre historike, tatimpaguesit i lejohet të vazhdojë amortizimin, në përputhje me udhëzimin nr.8, datë 12.2.1992 "Mbi normat e amortizimit të aktiveve të qëndrueshme, të personave fizikë dhe juridikë".

4. Baza e amortizimit të kompjuterëve, sistemeve të informacionit, produkteve "softëare" dhe sistemeve të ruajtjes së të dhënave, si dhe të të gjitha aseteve të veprimtarisë, të blera përpara datës 1 janar 1999, për periudhën tatimore 1999, do të jetë vlera e këtyre aktiveve në librin e madh më 1 janar 1999, rregulluar siç është përshkruar në nenin 22 pika gjashtë e këtij ligji.

5. Fitimi i tatueshëm për periudhën tatimore 1999 dhe 2000 të reduktohet me humbjet e pësuar nga tatimpaguesi përpara datës 1 janar 1999, të llogaritet në përputhje me nenin 8 të ligjit nr.7677, datë 3.3.1993 "Për tatimin mbi fitimin", në qoftë se këto humbje janë të regjistruara në deklaratat e fitimit të vitit 1998. Humbjet e pësuar në vitet 1996 dhe 1997 nuk mbarten.

6. Tatimpaguesit, që kanë përfituar lehtësi tatimore në përputhje me nenin 6 të ligjit nr. 7677, datë 3.3.1993 "Për tatimin mbi fitimin", i gëzojnë këto lehtësi sipas kushteve të parashikuara në ligjin e mësipërm.

7. Tatimpaguesit që kanë gëzuar lehtësi dhe përjashtime, sipas ligjeve nr.8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit" dhe nr.7811, datë 12.4.1994 "Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.782, datë 22.2.1994 "Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve"", të ndryshuar, i gëzojnë ato, sipas kushteve të parashikuara në këto ligje.

Tatimi mbi lojërat e fatit, sipas nenit 52/2, të ligjit nr. 155/2015, "Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, aplikohet me shkallën 15 % mbi të ardhurat bruto nga loja për të gjitha kategoritë e lojërave të fatit, përfshirë Lotarinë Kombëtare të licencuar sipas ligjit nr. 95/2013. E ardhura bruto nga loja është shuma e mbetur organizatorit nga diferenca midis shumës totale të luajtur nga lojtarët në lojërat e fatit dhe shumës së fituar prej tyre.

Tatimi mbi fitimin llogaritet në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Detyrimi i parë për deklarimin e të ardhurave individuale vjetore, për vitin fiskal 2011, nga subjektet e parashikuara në këtë ligj, duhet të bëhet jo më vonë se data 30 shtator 2012, ndërsa pagesa e tatimit, sipas pikës 2 të nenit 13/6, të bëhet jo më vonë se data 30 shtator 2012.

Kreditimi i shumave të përfituara nga skema e shpenzimeve të zbritshme, parashikuar në nenin 13/3 të këtij ligji, kryhet brenda datës 31 dhjetor të vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën është hartuar deklarata, për vitin 2011. Për vitet e tjera vijuese fiskale, afatet e mësipërme janë jo më vonë se data 30 prill.

Ndaj individëve, të parashikuar në këtë ligj, të cilët kanë bërë ose bëjnë deklarimin e të ardhurave personale për vitin fiskal 2011, pas datës 30 shtator 2012, nuk aplikohen gjobat për mosdeklarim në afat, për deklarimet e bëra deri në datën 31 dhjetor 2012.

8. Vetëm për periudhën tatimore të vitit 2013, subjektet e biznesit të vogël të tatimit mbi të ardhurat personale plotësojnë dhe dorëzojnë Deklaratën e Tatimit mbi të Ardhurat Personale të Biznesit të Vogël, sipas shkronjës "gj" të nenit 8 dhe neneve nga 12 deri në nenin 12/6 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, brenda datës 10 shkurt 2014.

9. Norma e tatimit mbi dividendin në shkallën 8 % do të aplikohet edhe për fitimet e pashpërndara të realizuara në vitet 2018 e më parë, përfshirë rezervat dhe fitimet e kapitalizuara,

me kusht që tatimi mbi dividendin, që i përket fitimeve të pashpërndara të viteve 2017 e më parë, të paguhet brenda datës 30 shtator 2019, ndërsa tatimi mbi dividendin për fitimin e vitit 2018 të paguhet brenda datës 20 gusht 2019.

Dispozita kalimtare

(e shtuar me ligjin nr.9716, datë 16.4.2007)

Neni 2, që ndryshon nenin 11 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 dhe neni 4, që ndryshon nenin 20 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, fillojnë të zbatohen më 1 janar 2008.

Dispozitë kalimtare

(e shtuar me ligjin nr.10 343, datë 28.10.2010)

Detyrimi i parë për deklarimin e të ardhurave vjetore, nga subjektet e parashikuara në këtë ligj, lind në vitin 2012, në të cilin, brenda datës 30 prill, dorëzohet deklarimi vjetor i të ardhurave për vitin 2011.

Dispozitë kalimtare

(e shtuar me ligjin nr. 39/2018, datë 9.7.2018)

Neni 2, që ndryshon nenin 20, "Shpenzime të njohura", të ligjit, nuk do të zbatohet për kontratat e shkëmbimit që janë regjistruar në ZRPP para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 39

Ligjet që shfuqizohen

1. Ligji nr.7786, datë 27.1.1994 "Për tatimin mbi të ardhurat personale", me ndryshimet përkatëse, si dhe të gjitha aktet e tjera, që vijnë në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

2. Ligji nr.7677, datë 3.3.1993 "Për tatimin mbi fitimin", me ndryshimet përkatëse, si dhe të gjitha dispozitat e tjera, që vijnë në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 40

Akte nënligjore

Ngarkohet Ministria e Financave për nxjerrjen e akteve nënligjore në bazë dhe për zbatim të këtij ligji.

Neni 41

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2289, datë 31.12.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**

PASQYRA NR. 1

(Ndryshuar me ligjet nr. 8711, datë 15.12.2000; nr. 8841, datë 11.12.2001; nr. 9326, datë 6.12.2004; nr. 9458, datë 21.12.2005; nr. 9766, datë 9.7.2007; nr. 107, datë 28.3.2013; nr. 177, datë 28.12.2013; nr. 94/2018, datë 3.12.2018)

Tabela për tatimin mbi të ardhurat personale nga punësimi

E ardhura e tetueshme në lekë/muaj	Përqindje	
	Deri në përfshirë	Zero për qind
<i>Nga</i>	<i>Deri në përfshirë</i>	<i>Zero për qind</i>
0	30 000	+
30 001	150 000	13 për qind të shumës mbi 30 000
	Më tepër	15 600 lekë+ 23 për qind të shumës mbi 150 000 lekë

PASQYRA NR. 2

ÇMIMI I SHITJES	TATIMI I PAGUESHËM	
<i>Mbi (lekë)</i>	<i>Në (lekë)</i>	<i>Për qindje</i>
0	2 000 000	0.5% çmimit të shitjes
2 000 000 +	4 000 000	1% çmimit të shitjes
4 000 000 +	6 000 000	2% çmimit të shitjes
6 000 000+	E më tepër	3% çmimit të shitjes

PASQYRA NR.3

(Shtuar me ligjin nr. 9161, datë 18.12.2003)

TARIFAT E TATIMIT TË THJESHTUAR MBI TË ARDHURAT

Nr.	Tipi (lloji) i biznesit	Tarifa e tatimit të thjeshtuar
1.	Shitje me pakicë	4 për qind
2.	Prodhim	4 për qind
3.	Shërbime	5 për qind
4.	Profesione të lira	5 për qind